



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 547 Akti

Nr. 703 Vendimi
Tiranë, më 28.9.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 26.9.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Suela Salavaçi**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b të Kushtetutës**, nenet A, B, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit shqyrtoi, gjithë dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Suela Salavaçi, aktualisht me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Alma Faskaj kryesuese dhe Etleda Çiftja anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Alma Faskaj. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier de Mongeot.
3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
4. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
5. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 1.9.2023, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Suela Salavaçi dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit, miratuar me shumicë votash nga paneli, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative dhe i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
6. Subjekti i rivlerësimit Suela Salavaçi, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 20.9.2023. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 26.9.2023.
7. Për një proces të rregullt ligjor, subjektit të rivlerësimit Suela Salavaçi i janë garantuar të drejtat: (i) për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t’u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegime mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t’u njohur me

dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 26.9.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.
9. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi rezultatet e hetimit lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT GJATË PROCESIT

10. Subjekti i rivlerësimit Suela Salavaçi ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Suela Salavaçi ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
12. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
14. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
15. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar raportin¹, duke konkluduar se:

¹ Raporti i ILDKPKI-së, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2018.

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/1. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 ka rezultuar se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
17. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.
18. Ky hetim u përqendrua mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Suela Salavaçi në deklaratën e pasurisë, shtojca 2. Subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 26.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi e ligjit nr. 84/2016², duke deklaruar pasuritë si vijon:

19. Apartament në rrugën “K.K”, Tiranë

19.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se apartamenti është porositur dhe paguar nga nëna, bazuar në kontratën e porosisë datë 10.3.2005. Vlera e deklaruar është 38.800 USD. Si burim krijimi janë deklaruar të ardhurat e familjes, nga kontratat e qirave, shitja e pasurive të paluajtshme etj.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

19.2 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se apartamenti është porositur dhe likuiduar nga nëna e saj, sipas kontratës së porosisë datë 10.3.2005 në vlerën 38.800 USD, e finalizuar nga subjekti me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.11.2013 dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.11.2013. Në deklarin periodik vjetor (në vijim DPV) të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “*Apartament me vlerë 38.800 USD*”.

19.3 ASHK Tirana Veri ka konfirmuar pasurinë apartament me sipërfaqe 121.36 m², nr. ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, në Tiranë, të regjistruar në emër të znj. Suela Salavaçi.

19.4 Nga aktet e administruara në dosje kanë rezultuar faktet si vijon:

i. Nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. L.S, në cilësinë e porositëses, ka lidhur një kontratë porosie datë 10.3.2005, me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k. (të përfaqësuar nga administratori

² Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

A.B) dhe investitorin T.M, për prenotimin e një apartamenti me sipërfaqe ndërtimi 137.5 m² dhe sipërfaqe shfrytëzimi 107.59 m², të ndodhur në katin e 11-të teknik, në adresën rruga “K.K” (Rr e B). Palët kanë përcaktuar çmimin e apartamentit në vlerën 38.800 USD, e cila është likuiduar totalisht nga blerësja L.S në favor të investitorit, në momentin e nënshkrimit të kontratës.

ii. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.2022, të lëshuar nga investitori T.M, i cili ndër të tjera deklaroi se çmimi i shitblerjes së apartamentit prej 38.800 USD është likuiduar nga blerësja L.S në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë datë 10.3.2005.

iii. Përmes deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2013, nëna e subjektit L.S ka hequr dorë nga pronësia e apartamentit duke ia dhuruar vajzës së saj Suela Salavaçi. Njëkohësisht, shoqëria ndërtuese dhe investitori kanë shprehur dakordësinë për kalimin e pronësisë së apartamentit nga shtetasja L.S në favor të subjektit Suela Salavaçi, si dhe kanë vendosur të shfuqizojnë kontratën e porosisë datë 10.3.2005.

iv. Më pas, subjekti Suela Salavaçi ka lidhur kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. ***kol., datë 20.11.2013, me shoqërinë ndërtuese dhe investitorin, duke regjistruar pasurinë në pronësi të saj, sipas çertifikatës së pronësisë datë 21.11.2013.

19.5 Komisioni ka verifikuar vlerën e tregut të lirë të apartamenteve sipas çmimit të EKB-së³ në vitin 2005, për gjithë zonën e Tiranës (pa zona të përcaktuara), ku vlera e tregut për apartamentet është 77.452 lekë/m² dhe për apartamentin vlera do të ishte 9.399.574 lekë, ndërsa nëna e subjektit e ka blerë këtë pasuri me çmimin 38.800 USD. Duket se çmimi i blerjes është më i ulët krahasuar me vlerën e tregut të lirë të apartamenteve sipas çmimit të EKB-së. Në dosje janë administruar dy kontrata të ngjashme shitblerjeje për apartamente me të njëjtën sipërfaqe dhe në të njëjtën godinë ku ndodhet apartamenti i blerë nga nëna e subjektit, ku çmimi i blerjes është 38.800 USD në vitin 2004 dhe 33.800 USD në vitin 2002.

19.6 Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë konflikt interesi të mundshëm të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë sipërmarrëse “****” sh.p.k., me administratorin dhe ortakun e saj A. B, si dhe investitorin T.M. Referuar rezultateve të hetimit nuk është evidentuar ndonjë rast konflikti interesi, sipas parashikimeve ligjore.

Lidhur me burimet e krijimit për blerjen e apartamentit

19.7 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit të ardhurat e familjes, të ardhurat nga kontratat e qirave, të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme etj.

19.8 Në deklaratën *Vetting*, si dhe gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar se ka bashkëjetuar me prindërit e saj që prej vitit 1998 dhe në vazhdim, në banesën në pronësi të babait P.S, e ndodhur në rrugën “D.B”, ku shpenzimet e jetesës janë mbuluar me të ardhurat e tyre të përbashkëta.

19.9 Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore, subjekti ka deklaruar si adresë banimi Njësia Administrative Nr. *, rruga “D.B”, nr. **, Tiranë, e njëjta adresë me banesën e prindërve. Sipas të dhënave të gjendjes civile, si dhe çertifikatat familjare të administruara në dosje, në

³ Udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2005”.

përbërjen familjare të subjektit Suela Salavaçi janë bashkëshorti i saj B.M (me të cilin ka lidhur martesë në datën 4.2.2000) dhe dy vajzat.

19.10 Komisioni, për shkak se pasuria është likuiduar sipas kontratës së porosisë në datën 10.3.2005 me të ardhurat e nënës së subjektit, e ka konsideruar znj. L.S “person tjetër të lidhur” në kuptim të nenit 3/14, dhe në cilësinë e dhurueses bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016 subjekti mbart detyrimin të depozitave dokumentacioni justifikues mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

19.11 Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitave dokumentacioni mbi të ardhurat e ligjshme të nënës, të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit. Subjekti ka shpjeguar se nuk mund të identifikojë një burim specifik që ka shërbyer për blerjen e apartamentit, pasi nëna ka pasur të ardhura të ndryshme nga pasuritë e trashëguara, me të cilat janë krijuar pasuritë.

19.12 Subjektit ka depozituar pranë Komisionit të gjithë dokumentacionin e disponuar mbi të ardhurat e prindërve të saj, pasuritë e krijuara dhe likuiditetet gjendje, të cilat janë administruar në dosjen e hetimit nga Komisioni.

Burimet e krijimit për pasurinë apartament në Tiranë

19.13 Si burim janë deklaruar të ardhurat e prindërve nga qiradhënia dhe shitblerjet e pasurive të trashëguara. Trupi gjykues kreu një vlerësim paraprak për të ardhurat e gjeneruara nga pasuritë e trashëguara, nga ku duket se për disa nga këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet tatimore, pra nuk janë në përputhje me parashikimin e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, nuk janë reflektuar në analizën kumulative financiare. Referuar analizës kumulative të prindërve në vite, duket se prindërit paraqiten me një balancë negative, të akumuluar në vite deri në fund të vitit 2004.

19.14 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se të ardhurat e prindërve të subjektit rrjedhin kryesisht sa vijon:

a) Të ardhurat nga pasuri të dhëna me qira

- të ardhurat nga qiradhënia e ish-Ambasadës së Francës nga viti 1995;
- të ardhurat nga pjesa takuese e tezes së nënës, pasi gjatë hetimit nga verifikimi i akteve ligjore, si në kontratat për shitblerje pasurie, ka rezultuar se këto akte ligjore nuk kanë nënshkrimin e tezes (me iniciale E. Dh.) me banim në Francë dhe as trashëgimtarët e saj nuk kanë përfituar asnjë të ardhur nga pasuritë trashëgimore.

Sipas deklarimeve noteriale të përfaqësuesve ligjore të trashëgimtarëve dhe sipas dokumentacionit bankar kanë rezultuar se të ardhurat e përfituara nga pasuritë e dhëna me qira kanë kaluar në llogaritë bankare të tyre, duke u depozituar çdo tremujor e, më pas, përfaqësuesit e trashëgimtarëve i kanë tërhequr plotësisht nga llogaritë bankare dhe i kanë shpërndarë në mënyrë të barabartë mes trashëgimtarëve ligjorë me banim në Shqipëri. Nuk u reflektuan në analizë pasi nuk u provuan pagesat e detyrimit tatimor.

b) Të ardhurat nga shitblerja e pasurive të paluajtshme

- të ardhurat e babait nga kontrata e shitjes datë 15.9.1993 (shitja e apartamentit në Peqin), në shumën 1.162.866 lekë;
- të ardhurat e nënës nga kontrata e shitje datë 19.7.2001 (vlera totale 320.000 USD), në shumën 4.306 USD;
- të ardhurat e nënës nga kontrata e shitjes datë 20.9.2002, në shumën 18.854 USD;
- të ardhurat e nënës nga aktmarrëveshja e datës 29.4.2003, në shumën 15.500.000 lekë.

c) Të ardhurat nga paga dhe pensionet e prindërve

- të ardhurat e nënës nga punësimi si mjeke nga viti 1994 e në vijim;
- të ardhurat e nënës nga punësimi në Greqi për periudhën 1997 – 2002, në shumën totale 421.423 lekë, për të cilat nuk u dokumentua pagesa mbi detyrimet tatimore;
- të ardhurat e babait nga pensioni i pleqërisë nga data 22.8.1994 dhe pension suplementar.

Analizimi i burimeve të deklaruara të të ardhurave të prindërve, përdorur si burim krijimi

a) Lidhur me pjesën takuese të nënës L.S nga pasuria trashëgimore

19.15 Komisioni ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e depozituar nga subjekti lidhur me burimin e pasurive që rrjedhin nga trashëgimia ligjore, sipas akteve mbi trashëgiminë ligjore në vijim.

19.16 Në datën 1.11.1993 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë nr. ***, datë 1.11.1993, nga noteri, për të ndjerin Dr. S.S, duke u caktuar trashëgimtarë ligjorë të radhës së tretë fëmijët e vëllezërve dhe motrave të tij, ku për pjesën e motrës së paravdekur A.K(S), e cila i përket trungut familjar “K”, trashëgimia ka kaluar tek fëmijët e saj: M.K; E.Dh(K) banuese në Francë; A.K banuese në Greqi, Sh.M(K), të cilët trashëgojnë 1/15 pjesë të pasurisë secili, si dhe vajza E. G (K), e cila ka ndërruar jetë në vitin 1947 dhe pasuria kalon me zëvendësim tek fëmijët: K.G; S. G; dhe E.S, të cilët zotërojnë 1/45 pjesë/secili të pasurisë së trashëgimlënësit Dr. S.S.

19.17 Në rezultatet e hetimit reflektohet pema e trashëgimisë së trashëgimlënësit Dr. S. S, bazuar në dëshminë e trashëgimisë së lëshuar nga noteri në datën 1.11.1993.

Sa më sipër, sipas dëshmisë së trashëgimisë datë 1.11.1993, nëna e subjektit L.S ka trashëguar 1/45 pjesë të pasurive trashëgimore të Dr. S.S.

19.18 Referuar vërtetimit hipotekor të pasurisë me nr. ***, datë 24.10.1996, ku ndodhet objekti ish-Ambasada e Francës (pasuri e trashëguar nga trashëgimlënësi Dr. S.S), nëna e subjektit L. S rezulton bashkëpronare në këtë pasuri me 1/72 pjesë takuese.

19.19 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë arsyet e ndryshimit të pjesës takuese të nënës nga 1/45 në 1/72 pjesë. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore të lëshuar nga noteri publik me nr. ***, datë 1.11.1993, për trashëgimtarët e Dr. S.S, pjesa takuese e nënës L.S është 1/45 pjesë, ashtu siç pasqyrohet edhe në vërtetimin e pronësisë datë 10.10.1995, lëshuar nga Hipoteka Tiranë. Më pas subjekti ka shpjeguar se lista e trashëgimtarëve është shtuar, të cilët nuk ishin përfshirë në dëshminë e parë të trashëgimisë ligjore. Sipas subjektit, pas lëshimit të dëshmisë së plotë të trashëgimisë ligjore ka ndryshuar edhe pjesa takuese e secilit trashëgimtar dhe nëna bëhet trashëgimtare e 1/72 pjesë takuese (nga 1/45 që ishte më parë), siç vërtetohet nga vërtetimi hipotekor datë 22.7.2003.

19.20 Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitohet dëshminë e dytë të trashëgimisë, përmes së cilës ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve, për të cilën subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 2.7.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku, sipas këtij vendimi, znj. L.S rezulton trashëgimtare me 1/72 pjesë të pasurisë trashëgimore të trashëgimtarit S.S. Nga përmbajtja e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 2.7.1996, evidentohen dy fakte:

Së pari, në dëshminë e parë të trashëgimisë nr. ***, datë 1.11.1993, nuk ishin njohur si trashëgimtare ligjore tri motrat e të ndjerit Dr. S.S, që janë U.S(S), V.P (S) dhe T.C (S), për shkak se ndodheshin jashtë shtetit dhe nuk kishin paraqitur dokumentacionin e nevojshëm në momentin e nxjerrjes së dëshmisë. Për rrjedhojë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lëshimin e dëshmisë së re të trashëgimisë, duke ndryshuar pjesën takuese të secilit trashëgimtar, ku nëna e subjektit L.S trashëgon 1/72 pjesë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 17.7.1996.

Së dyti, në vendim evidentohet fakti se tezja e nënës së subjektit, znj. A.K (trashëgimtare e S.S sipas dëshmisë së parë të trashëgimisë së datës 1.11.1993 me 1/15 pjesë trashëgimore), nuk bën pjesë në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë, pasi kjo shtetase është birësuar, për rrjedhojë është përjashtuar nga trashëgimia e Dr. S.S, pasi ajo është trashëgimtare e familjes birësuese. Subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 2.9.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me paditës M.K dhe të paditur A.N, me objekt kthimin e shumës 1.396 USD të përfituar nga qiradhënia e objektit me Ambasadën Franceze, pasi kjo shtetase është përjashtuar nga trashëgimia e Dr. S.S, sipas dëshmisë së trashëgimisë me vendimin e Gjykatës nr. ***, datë 2.7.1996, ndryshe nga dëshmia e parë e trashëgimisë së lëshuar nga noteri me nr. ***, datë 1.11.1993, ku znj. A.K rezultonte trashëgimtare e pasurive S.

19.21 Komisioni ka administruar nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug praktikën e regjistrimit të pronave të trashëguara nga nëna L.S (prej origjinës së tyre), ku evidentohen dy dëshmitë e trashëgimisë ligjore të viteve 1993 dhe 1996 të të ndjerit S.S.

19.22 Komisioni verifikoi vërtetësinë e deklarimeve dhe nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të administruar në dosje ka rezultuar se nëna e subjektit është një nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Dr. S.S.

19.23 Në lidhje me analizimin e këtyre të ardhurave nga pasuritë e trashëguara, Komisioni është bazuar në aktet e trashëgimisë të administruara në dosje, ku pjesa takuese e nënës në pasurinë trashëgimore ka qenë 1/45 pjesë në vitet 1993 – 1996 (sipas dëshmisë së trashëgimisë datë 1.11.1993) dhe 1/72 pjesë takuese nga viti 1996 dhe në vijim (referuar dëshmisë së trashëgimisë sipas vendimit gjyqësor datë 2.7.1996).

b) Të ardhurat nga qiradhënia e pronës ish-Ambasada e Francës për periudhën 1995 – 2005

19.24 Nga dokumentacioni i ardhur nga ASHK Tirana Jug ka rezultuar se prona është e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 24.10.1996, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe truall 2.869 m², në të cilin ndodhet një ndërtesë 3 kate (ish-Ambasada e Francës), ku nëna e subjektit L.S (në akte përmendet me emrin E.S) zotëron 1/72 pjesë të pronës në bashkëpronësi.

19.25 Komisioni ka verifikuar origjinën e kësaj pasurie, e cila rrjedh nga vendimi nr. ***, datë 14.9.1994, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, sipas të cilit trashëgimtarëve të S.S u është kthyer pronësia mbi godinën 3-katëshe (sot Ambasada e Francës).

19.26 Në lidhje me këtë pasuri janë administruar nga Komisioni kontratat si vijon:

a) *Kontratë qiraje datë 30.3.1995* e lidhur midis qiramarrësit Ambasada e Francës në Tiranë dhe qiradhënësve bashkëpronarë (trashëgimtarë të S.S), për dhënien me qira të vilës dhe kopshtit të zënë nga Ambasada, për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 1.1.1995, me qira mujore 7.338 USD, pagesë e cila do të kryhet çdo tremujor. Palët kanë përcaktuar se pagesa e qirasë do të kryhet me xhirim bankar nga Ambasada e Francës në një llogari të hapur në Tiranë, të caktuar me marrëveshje nga bashkëpronarët.

b) *Kontrata e qirasë datë 21.9.2000*, e lidhur midis qiramarrësit Ambasada e Francës dhe qiradhënësve bashkëpronarë të përfaqësuar nga z. M.K (mbajtësi i shumicës së prokurave). Kjo kontratë është lidhur për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar nga data 1.1.2000, me vlerë qiraje mujore 9.000 USD/muaj, pagesë e cila do të kryhet çdo tremujor. Palët kanë përcaktuar se pagesa e qirasë do të kryhet me xhirim bankar të bërë nga Ambasada e Francës në Tiranë në llogarinë e hapur nga z. M.K, në emër të trashëgimtarëve të Dr. S pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë.

c) *Kontrata e qirasë datë 27.1.2003*, e lidhur midis qiramarrësit Ambasada e Francës në Tiranë dhe qiradhënësve bashkëpronarë të përfaqësuar nga shtetasi K.G (mbajtës i shumicës së prokurave). Afati i kontratës është përcaktuar për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar nga data 1.1.2003, me qira mujore 9.000 USD, e cila do të kryhet çdo tremujor. Palët kanë përcaktuar se pagesa e qirasë do të kryhet me xhirim bankar në llogarinë e hapur nga përfaqësuesi K.G, në emër të trashëgimtarëve të Dr. S pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë.

19.27 Gjatë hetimit kanë rezultuar të ardhurat nga qiraja që janë përfituar nëpërmjet bankës dhe ndaheshin *cash* më pas ndërmjet bashkëpronarëve të çdo trangu dhe të ardhurat nga qiraja janë përfituar sipas përcaktimeve në kontratën e qirasë.

19.28 Komisioni ka administruar në dosje një *statement* bankar të ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Amerikane), ku duket se në llogarinë e shtetasit K.G janë depozituar pagesa qiraje (3-mujore), që i përkasin periudhës 2000 – dhjetor 2006.

19.29 Në vijim, Komisioni ka kërkuar informacion më të detajuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, nëse ka detyrime tatimore të paguara nga shtetasja L.S, si dhe bazën ligjore mbi detyrimin e pagimit të tatimit në burim, në rastin kur qiramarrësi është entitet i huaj (ish-Ambasada e Francës).

19.30 Drejtorja Rajonale Tatimore ka informuar se nga verifikimet e kryera për shtetasen L. S dhe subjektin Ambasada e Francës nuk disponojnë deklarime dhe pagesa lidhur me tatimin në burim për periudhën 1995 – 2016, si dhe ka referuar bazën ligjore për tatimin mbi të ardhurat për periudhën 1994 – 2016. Gjithashtu, DRT-ja ka informuar se për shtetasit M.K dhe K.G (përfaqësuesit e qiradhënësve), duke mos pasur një sistem unik, e kanë të pamundur të identifikojnë transaksionet për tatimin në burim për periudhën 1995 – 2007.

19.31 Subjekti ka provuar përmes kontratave të qirasë se pasuria i është dhënë me qira ish-Ambasadës së Francës për periudhën nga 1995 – 2004 dhe sipas të dhënave bankare provohet se përfaqësuesit e trashëgimtarëve S kanë përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie, ku përfshihet edhe pjesa takuese e nënës së subjektit. Këto të ardhura nuk janë reflektuar në analizë financiare, pasi nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore në përputhje me nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

c) Të ardhurat nga kontrata e shitblerjes nr. * rep., nr. *** akti, datë 15.9.1993**

19.32 Gjatë hetimit subjekti ka deklaruar se babai ka shitur një apartament të ndodhur në qytetin e Peqinit në pronësi të tij kundrejt çmimit 1.200.000 lekë (përshkruar në kontratë 12 milionë lekë të vjetra) përmes kontratës së shitblerjes datë 15.9.1993. Nga aktet në dosje rezulton se kjo pasuri është përfituar nga babai i subjektit nga privatizimi i banesave shtetërore me kontratën e shitjes datë 17.6.1993, kundrejt vlerës 37.134 lekë.

19.33 Komisioni ka reflektuar në analizë financiare të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie në vlerën 1.162.866 lekë (1.200.000 lekë - 37.134 lekë).

c) Të ardhurat nga kontrata e shitjes datë 19.7.2001, në shumën totale 320.000 USD

19.34 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura të realizuara nga nëna, bazuar në kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.7.2001, të lidhur midis blerësit shoqëria “***” sh.p.k. dhe 34 trashëgimtarëve të S.S në cilësinë e shitësve, ku palë e kontratës është edhe nëna e subjektit E.G (S), e përfaqësuar me prokurë nga vëllai K.G.

19.35 Objekti i kësaj kontrate është shitja e një trualli me sip. 1.102 m² dhe ndërtesë 1-katëshe, në Tiranë, kundrejt çmimit 320.000 USD. Nga kjo shitblerje nëna e subjektit L.S ka përfituar shumën 4.306,55 USD.

19.36 Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar se pjesa që ka përfituar fisi K është 51.678,66 USD, nga të cilat nëna ka përfituar shumën 4.306,55 USD dhe pjesa takuese e tezes së nënës me banim në Francë në shumën 12.919,66 USD, e cila i është shpërndarë në mënyrë të barabartë 5 pjesëtarëve të fisit.

19.37 Në dokumentin e shpërndarjes së shumave, si dhe në kontratën e shitjes datë 19.7.2001, tezja e nënës nuk rezulton të ketë firmosur. Sipas subjektit, shuma e përfituar nga shitja e kësaj prone është 6.890,48 USD (pjesa takuese e nënës 4.306,55 USD + pjesa takuese e tezes së nënës 12.919,66 USD/5).

19.38 Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të saj, ka depozituar deklaratën noteriale nr. **, datë 10.5.2001, nëpërmjet së cilës fisi Kapo ka garantuar blerësin se për çdo pretendim në të ardhmen nga E.Dh (K) dhe trashëgimtarët e saj që jetojnë në Francë do ta zgjidhin duke e mënjanuar blerësin në të gjitha rastet.

19.39 Gjithashtu, subjekti ka depozituar deklarata noteriale të lëshuara nga shtetasi S.G (daja i subjektit) dhe deklaratën noteriale të avokates B (përfaqësuese me prokurë e trashëgimtarëve të së ndjerës E.Dh.K), të cilët, ndër të tjera, kanë deklaruar se të ardhurat nga shitja e kësaj prone

janë shpërndarë midis bashkëpronarëve banues në Shqipëri dhe trashëgimtarët e E.Dh nuk kanë përfituar të ardhura nga kjo kontratë shitblerjeje datë 19.7.2001.

19.40 Në lidhje me pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2023, të nënshkruar elektronikisht nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug dhe dokumentacionin ku provohet pagesa e tatimit për këtë kontratë.

d) Kontrata e shitjes datë 20.9.2002, në shumën 18.854 USD

19.41 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2002, me palë shitëse trashëgimtarët e familjeve S, K, P, S, P, C (midis të cilëve është edhe znj. L.S) dhe palë blerëse S.Z.

19.42 Objekti i kësaj kontrate është shitja e një trualli të zënë nga godina e ish-shkollës “K” me sipërfaqe 748 m² dhe oborr me sip. 1720.5 m², në total një sipërfaqe prej 2468.5 m², kundrejt çmimit 550 USD/ m².

19.43 Palët kanë përcaktuar se pagesa do të realizohet duke paguar çdo person sipas pjesës që i takon *cash* në dorë ose me çek, e cila do të tërhiqet në Bankën Amerikane. Shitësit do të firmosin kontratën dhe do të marrin çekun në emrin e secilit, duke vendosur përbri emrit dhe numrin e çekut, veprim i cili do të bëhet në zyrën e noterit. Referuar kontratës, shuma e përfituar nga nëna nga shitja e kësaj pasurie është në vlerën 18.854 USD.

19.44 Lidhur me të ardhurat nga shitblerja e kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se pjesa takuese e përfituar nga nëna është në shumën 18.854 USD dhe pjesa që duhet të përfitonte tezja e nënës E.K është 1/24 ose 56.567 USD, e cila është përpjesëtuar në mënyrë të barabartë midis 5 trashëgimtarëve të familjes K. Në këtë kontratë evidentohet se shtetasja E.K nuk ka nënshkruar kontratën dhe nuk ka nënshkruar shumën për pjesën e saj takuese në tabelën përmbledhëse për familjen K.

19.45 Në lidhje me pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2023, të nënshkruar elektronikisht nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug dhe dokumentacionin mbështetës ku provohet pagesa e tatimit për këtë kontratë.

19.46 Në analizën financiare është konsideruar pjesa takuese e nënës në shumën 18.854 USD, e konvertuar në lekë me kursin mesatar të vitit.

dh) Lidhur me aktmarrëveshjen nr. * rep., datë 29.4.2003**

19.47 Gjatë hetimit subjekti ka depozituar aktmarrëveshjen datë 29.4.2003, të lidhur midis shtetasës L.S (nëna) si pronare trualli dhe investitorit A.Xh, përmes së cilës është rënë dakord dhënia për zhvillim (ndërtim) e pjesës së saj takuese nga pronat e ish-pronarëve K.K dhe M.K, kundrejt çmimit 15.500.000 lekë, likuiduar në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes.

19.48 Objekt i kësaj aktmarrëveshjeje janë pasuritë:

- truall i përfituar sipas vendimit nr. **, datë 13.9.1993, të KKKP ish-Pronarëve;
- pyll - kullotë me sip. 60.000 – 100.000 m².

19.49 Sipas përmbajtjes së aktmarrëveshjes, këto pasuri do t'i jepen për zhvillim (ndërtim) palës investitore deri në miratimin e të drejtës së pronësisë, ndërsa pala investitore deklaron se do t'i japë palës pronare të truallit (kullotë), si garanci kontraktuale, shumën 15.500.000 lekë, e cila i kalon menjëherë me lidhjen e kësaj aktmarrëveshjeje. Në këtë aktmarrëveshje palët kanë përcaktuar se kjo shumë shërben si parapagim për llogari të bashkëpronares së truallit dhe pasi palët të lidhin kontratën e sipërmarrjes për dhënien e truallit për ndërtim dhe të zgjidhen sipërfaqet ndërtimore takuese, pala pronare e truallit do të konsiderohet e kompensuar për sipërfaqen ndërtimore që i takon shumës së dhënë në këtë vlerë monetare.

19.50 Nisur nga fakti se me vendimin nr. **, datë 13.9.1993, të KKKP-së, ish-pronarëve K. K dhe M.K u janë kthyer 5 pasuri të llojit truall, në Jalë dhe Vuno, Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë se cila nga këto 5 pasuri truall është objekt i kësaj kontrate.

19.51 Subjekti ka shpjeguar se ky vendim është vetëm për një pjesë të sipërfaqes së truallit, ndërsa në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ndodheshin në shqyrtim edhe dy dosje të tjera me nr. ***/1996 dhe nr. ***/1993, ku, sipas subjektit, përfshihet e gjithë sipërfaqja për të cilën është lidhur aktmarrëveshja e sipërcituar.

19.52 Nga aktet në dosje rezulton se sipërfaqja prej 700 m² truall në Jalë, e kthyer sipas vendimit nr. **, datë 13.9.1993, të KKKP-së, është shitur nga trashëgimtarët me kontratën premtim-shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2012, nga e cila nëna e subjektit ka përfituar me transaksion bankar shumën 14.500 euro.

19.53 Këto të ardhura nuk u morën në konsideratë në rezultate të hetimit, pasi nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore për to.

19.54 Lidhur me shumën 15.500.000 lekë të paguar sipas aktmarrëveshjes datë 29.4.2003, Komisioni i ka kërkuar subjektit të qartësojë mënyrën e marrjes së parave nga kjo kontratë dhe ku janë mbajtur nga nëna e saj, pas marrjes së tyre.

19.55 Subjekti ka shpjeguar se shuma 15.500.000 lekë është marrë menjëherë me lidhjen dhe nënshkrimin e aktmarrëveshjes, ku kjo shumë është marrë *cash* dhe pjesa më e madhe e saj është konvertuar në monedhën dollar. Subjekti ka saktësuar se: *“Në vitin 2003, periudhë që nëna ka përfituar këtë shumë, ka pasur një pasiguri të madhe në sistemin bankar. Ju sjell në vëmendje krizën e rrjedhjes së depozitave në muajt mars dhe prill të vitit 2002. Tërheqjet e depozitave gjatë këtyre dy muajve krijuan një situatë paniku financiar tek publiku duke rritur ndjeshëm pasigurinë në sistemin bankar. Për këtë arsye mendoj se nuk është depozituar menjëherë shuma e konvertuar në USD, por nëna ka pritur stabilizimin dhe kthimin e besimit në sistemin bankar. Depozitimi i të hollave në pjesën më të madhe të tyre është bërë gjatë vitit 2004 dhe 2005”*.

19.56 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë arsyen pse kjo kontratë nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të ardhurash, si një burim ky i konsiderueshëm ndër burimet e tjera të deklaruara. Subjekti ka shpjeguar se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të gjithë informacionin që dispononte në momentin e plotësimit të saj. Subjekti sqaron se nëna nuk ka qenë ndonjëherë subjekt që mbart detyrimin për deklarim dhe për subjektin ka qenë e vështirë të mbledhë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej prindërve të saj.

19.57 Më tej, subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur informacion për aktmarrëveshjet që nënshkruanin bashkëpronarët, si dhe historikun e problematikave për pronësinë në këto pasuri.

19.58 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se: *“Pasi kam disponuar aktmarrëveshjen e vitit 2003, kam mësuar se nëna ka hezituuar të më vendosi në dispozicion këtë aktmarrëveshje, pasi kërkonte që ky dokument të ishte “konfidencial” në raport me bashkëpronarët e tjerë. Në rubrikën “Deklarimi i pasurive” kam përshkruar si burim krijimi të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme, për aq sa më është vendosur në dispozicion nga nëna ime. Pjesa më e madhe e parapagimit prej 15.500.000 lekësh, pasi është konvertuar në USD dhe depozituar në bankë, ka qëndruar në llogari depozite dhe vazhdon të qëndrojë aktualisht në bankat e nivelit të dytë, kurse pjesa tjetër është përdorur nga nëna për nevojat e saj. Sqaroj Komisionin se nëna ime ka qenë me profesion mjekje dhe ka pasur gjithmonë të ardhura nga shitjet e pronave, qiratë, punët që ka bërë brenda dhe jashtë vendit, lëvizjet bankare etj. dhe ka qenë e aftë për të menaxhuar të ardhurat dhe pasuritë e saj”.*

19.59 Komisioni i ka kërkuar subjektit të deklarojë nëse është rishpërndarë nga nëna tek trashëgimtarët e tjerë ndonjë pjesë nga këto të ardhura dhe nëse po, të saktësojë shumat.

19.60 Subjekti ka shpjeguar se shuma e parave të përfituara nga nëna sipas aktmarrëveshjes së vitit 2003 i përket vetëm pjesës takuese të saj, aktmarrëveshje e cila u lidh me kërkesën e shtetasit A.Xh për të pasur të drejtë tek bashkëpronësia dhe të kishte më shumë mundësi që ai do të ishte zhvilluesi i asaj prone, për këtë arsye u krye edhe parapagimi i shumës 15.500.000 lekë.

19.61 Këto të ardhura nuk u morën në konsideratë në rezultate të hetimit, pasi nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore për to.

Analiza financiare

19.62 Analiza mbi mundësitë e prindërve për blerjen e apartamentit objekt hetimi pas marrjes në konsideratë të të ardhurave sipas arsytimit të mësipërm, ka rezultuar me balancë negative në shumën 6.1 milionë lekë, pasi në të nuk u përfshinë të ardhura për të cilat nuk ishte provuar pagimi i tatimit.

19.63 Lidhur me këtë pamundësi financiare të prindërve të saj për krijimin e kësaj pasurie, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me të ardhurat nga qiradhënia e pronës, ish-Ambasada e Francës

19.64 Subjekti ka prapësuar se detyrimi tatimor për këtë marrëdhënie qiraje nuk ka qenë në asnjë rast përgjegjësi e bashkëpronësisë. Sipas subjektit, përfitimi i të ardhurave nëpërmjet sistemit bankar vërteton plotësisht se Ambasada e Francës ka pasur detyrim, si agjent i mbajtjes së tatimit në burim të llogarisë, të mbajë dhe të paguajë shumën e detyrimit të tatimit në burim.

19.65 Në mbështetje të prapësimeve të saj, subjekti ka referuar ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku në nenin 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” përcaktohet se: *“1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni*

në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme (dh) pagesat për qiratë”.

19.66 Gjithashtu, në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 (i ndryshuar), në pikën 5.5 “Evidentimi i tatimit të mbajtur në burim”, përcaktohet se: *“Tatimi i mbajtur në burim evidentohet nëpërmjet regjistrimeve në librat përkatës të evidentimit, të cilat përmbajnë të dhëna të plota identifikuese për personat përfitues, ... personi rezident i regjistruar për qëllime tatimore, i cili kryen pagesat sipas përcaktimeve të nenit 33, të ligjit, duhet t’ia vërë ato në dispozicion administratës tatimore dhe personave përfitues të të ardhurave, për të cilat është bërë pagesa, kur një gjë e tillë kërkohet”.*

19.67 Subjekti i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të kërkuar informacion për legjislacionin e kohës 1995 – 2006, nëse qiradhënësit (bashkëpronarë individë të paregjistruar në organet tatimore) kanë pasur detyrim për pagesën e tatimit në burim në rastin kur qiramarrësi është Ambasada e Francës, e regjistruar si tatimpaguese në organet tatimore me NIPT J***I. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

19.68 Me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.9.2023, të DPT-së e cila informon se:

- Vitet 1994 – 1998, në të cilët kanë qenë në fuqi dispozitat e ligjit nr. 7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe udhëzimi nr. 7, datë 5.4.1994 (dalë në zbatim të ligjit), në nenin 7 të ligjit përcaktohet se: *“Çdo individ a ndërmarrje që përfiton shërbime si nga marrëdhënia i punësuar-punësues ashtu edhe nga marrëveshje për shërbim individuale, mban tatimin për të ardhurat personale dhe e derdh atë në buxhetin e shtetit”.*
- Ndërsa për vitet 1998 – e në vazhdim është në fuqi ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006, i ndryshuar, ku në këtë ligj përcaktohet parimi i mbajtjes në burim të tatimit për tatimpaguesit që nuk janë të regjistruar në administratën tatimore.
- Në pikën 1 të nenit 33 të këtij ligji përcaktohen kategoritë e të ardhurave, për të cilat mbahet tatimi në burim nga personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër i njohur nga legjislacioni në fuqi, ndër këto janë dhe pagesat për qiratë. Për sa më sipër, në zbatim të këtij neni, qiramarrësi, qoftë ky edhe trup diplomatik (ambasadë), llogarit, mban dhe paguan në administratën tatimore tatimin për pagesën e qirasë.

19.69 Referuar kësaj shkrese dhe ligjit nr. 8438/1998, subjekti pretendon se detyrimi për mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim i takon Ambasadës së Francës.

19.70 Subjekti pretendon se sikurse Komisioni ka njohur të ardhurat nga qiraja në rastin kur qiramarrësi është shoqëria “***” sh.p.k. (e përfaqësuar nga shtetasi A.M), me të njëjtin argument Komisioni duhet të njohë edhe të ardhurat nga qiraja në periudhën 1995 – 2006, në shumën 2.200.086 lekë.

19.71 Sipas subjektit, ky konkluzion është në përputhje edhe me orientimin e mbajtur në vendimin orientues nr. 15/2021 të Kolegjit, i cili orienton Komisionin që vlerësimi i të ardhurave për të cilat nuk vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore duhet të bëhet në raport me rrethanat. Në rastin konkret, subjekti ka parashtruar se realizimi i të ardhurave nga qiraja është vërtetuar për

shkak se ato janë paguar nga Ambasada e Francës me bankë dhe nga ana tjetër bashkëpronarët nuk mund të konsiderohen në keqbesim për përfitimin e këtyre të ardhurave, për shkak se detyrimi për mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim i takon Ambasadës së Francës, e cila është subjekt tatimor i regjistruar në organet tatimore.

19.72 Për të njëjtat të ardhura, subjekti ka referuar edhe një qëndrimi të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me vendimin nr. 682, datë 10.7.2023, ku një subjekt tjetër deklarues ka përfituar të ardhura me dhurim nga gjyshja e tij (e cila është një nga bashkëpronarët e pasurisë së dhënë me qira) për të njëjtat të ardhura, ku përfshihet edhe nëna e subjektit.

Lidhur me të ardhurat nga pjesa takuese e tezes

19.73 Subjekti ka referuar të gjitha aktet e shitblerjes të nënshkruara midis trashëgimtarëve, në cilësinë e shitësve, ku evidentohet se tezja e nënës nuk ka nënshkruar këto kontrata, konkretisht:

- Në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme datë 19.7.2001 rezulton se në listën e përfituesve bashkëngjitur kontratës, për tezen E.Dh nuk ka firmosur asnjë përfaqësues për tërheqjen e shumës monetare, që rrjedhimisht tregon se për tezen nuk është bërë shpërndarje e të ardhurave nga shitja e pasurisë së paluajtshme.
- Deklarata noteriale nr. ***, datë 10.5.2001, nëpërmjet së cilës deklaruesit Sh.M.K, M. K, E.G (S), S.G dhe K.G garantojnë blerësin se *çdo pretendim nga motra dhe tezja jonë E. Dh (K) dhe trashëgimtarët e saj, që jetojnë në Francë, do ta zgjidhim ne, duke mënjanuar në të gjitha rastet e mundshme blerësin.*
- Në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme datë 20.9.2002, për tezen E.K, shuma 56.567,5 USD nuk është firmosur e, rrjedhimisht, kjo shumë monetare është shpërndarë ndërmjet anëtarëve të tjerë të familjes K.
- Në kontratën e shitblerjes datë 14.1.2010 nuk rezulton se trashëgimtarët e tezes E.K kanë firmosur dhe kanë përfituar të ardhura.

19.74 Gjithashtu, subjekti referon edhe përgjigjen e dhënë pranë Komisionit nga përfaqësuesja me prokurë, av. M.B, e trashëgimtarëve të tezes E.Dh (K), e cila ka sqaruar se e ndjera E.K dhe trashëgimtarët e saj nuk kanë përfituar të ardhura nga kontratat e qirasë të ish-godinës së rezidencës së Ambasadës Franceze, si dhe të ardhura nga kontratat e shitblerjes së viteve 2001, 2002 dhe 2010.

19.75 Për më tepër, në përmbajtje të prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2019, trashëgimtarët e së ndjerës E.K kanë autorizuar av. M.B që të kërkojë shumat e përfituara nga qiratë dhe nga çdo kontratë tjetër e nënshkruar në emër dhe për llogarinë e tyre nga përfaqësuesi i mëparshëm K.G.

19.76 Bazuar në të gjitha faktet e paraqitura më lart, subjekti pretendon se tezja E.Dh (K) apo trashëgimtarët e saj nuk rezulton të kenë përfituar të ardhura, si nga kontratat e qirasë ashtu edhe nga kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme, të paktën deri në vitin 2010 sikurse konfirmohet dhe prej përfaqësueses së trashëgimtarëve.

19.77 Tezja E.Dh është pjesë e familjes K dhe të ardhurat e pjesës takuese të saj janë shpërndarë midis anëtarëve të tjerë të kësaj familjeje, sikundër kanë vepruar edhe përfaqësues të tjerë të bashkëpronësisë sipas trungjeve familjare.

19.78 Subjekti ka prapësuar se nëse do të shihen transaksionet bankare të kryera nga shtetasi K.G (të marra dhe të disponuara në vite), do të konstatohet fare qartë fakti se asnjëherë ai nuk ka transferuar para në emër të shtetases E.Dh (K), ashtu siç ka vepruar me trashëgimtarë të tjerë që jetojnë jashtë Shqipërisë. Subjekti shpjegon se deri më sot nuk ka asnjë kërkesëpadi me të cilën të kërkohej kthime të shumave të ardhura prej qirasë apo shitjes së pasurive të paluajtshme nga trashëgimtarët e znj. E.Dh (K).

Lidhur me të ardhurat nga aktmarrëveshja nr. *** rep., datë 29.4.2003

19.79 Subjekti ka depozituar si provë shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.9.2023, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila informon se bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 11 (pikat 2 dhe 3) “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, si dhe në udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, tatimi paguhet përpara kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme dhe Zyra e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme nuk regjistron pasurinë pa u provuar pagimi i tatimit. Sa më sipër, DPT-ja informon se të ardhurat e përfituara sipas kontratës premtim-shitjeje do të tatohen në momentin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme.

19.80 Subjekti ka argumentuar se tatimi mbi shitjen e pasurisë paguhet para kryerjes së regjistrimit dhe Zyra e Regjistrimit shërben si agjent i mbajtjes së tatimit, duke përlllogaritur dhe mbledhur këtë shumë tatimi. Sipas subjektit, nëse pronarët do të kishin dashur të paguanin tatimin, ata nuk kishin mundësi të kryenin një pagesë të tillë, pasi pagesa e tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë kryhet vetëm në Zyrën e Regjistrimit. Çdo pagesë e kryer jo në formën e përcaktuar nga ligji nuk do të njihej dhe pronarët do të paguanin dy herë këtë tatim.

19.81 Subjekti ka referuar nenin 8, shkronja “dh” e ligjit nr. 8438/1998, si dhe udhëzimin nr. 29/2018 (pika 2), sipas të cilëve vetëm me lidhjen e kontratës së shitjes apo dhurimit dhe depozitimit në ASHK lind detyrimi për të paguar tatimin. Tatimi përlllogaritet nga vetë sistemi i ASHK-së dhe nuk mund të realizohet kalimi i pronësisë pa u paguar tatimi sipas ligjit. Pra, këto parashikime ligjore e lidhin pagesën e tatimit me momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, si një nga format e kalimit të pronësisë, sikurse përcaktohet në Kodin Civil.

Vlerësimi i Komisionit

19.82 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

- Në analizë të arsytimit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke mbajtur në konsideratë se nëna e subjektit u provua nga hetimi administrativ se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar këtë pasuri duke analizuar dhe dokumentacionin, shpjegimet e provat e sjella nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse lidhur me mundësinë financiare të prindërve të saj për krijimin e kësaj pasurie, duke arritur në përfundimin se nga hetimi u krijuar bindja se prindërit kanë pasur mundësi të investojnë në këtë pasuri të paluajtshme dhe se nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

19.83 Komisioni çmon se shumat e përfituara nga nëna sipas pjesës së saj takuese, nga qiradhënia e objektit ish-Ambasada e Francës, duhen konsideruan të ligjshme dhe duhen reflektuar në analizën kumulative të prindërve të subjektit, duke mbajtur në konsideratë edhe faktet e rrethanat vijuese të çështjes si:

- Vërtetohet pagesa në rrugë bankare e qirave nga Ambasada e Francës në favor të përfaqësuesve të trashëgimtarëve, por nuk vërtetohet pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga qiratë sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe në referencë të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas së cilës *“Në rast se qiramarrësi është person juridik, (rezident tatimor në Shqipëri) dhe që bën pagesë të qirasë, mban në burim (në momentin e pagesës) tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor”*, detyrimi për pagesën e tatimit mbi qiratë nuk ka qenë i nënës së subjektit, si një prej qiradhënësve.

- Nga hetimi administrativ është provuar bindshëm përfitimi i të ardhurave nga qiratë nga trashëgimtarët S, ndër ta edhe nëna e subjektit në kohën e krijimit të tyre, periudha 1995 – 2005; nuk u evidentua asnjë sjellje e subjektit që të ketë lidhje me pagesa të qirave nga pala qiramarrëse dhe ajo nuk rezulton të ketë qenë e përfshirë në asnjë rast në marrëdhëniet e qirasë.

Lidhur me të ardhurat e qirasë nga tezja e nënës, znj. E.Dh (K)

19.84 Nisur nga faktet e rezultuara gjatë hetimit dhe rrethanat e çështjes ka rezultuar se tezja e nënës nuk ka nënshkruar në asnjë prej akteve për marrjen e shumave të përfituara nga shitja e pasurive trashëgimore, si dhe nisur nga deklaratat noteriale e vitit 2001, ku trashëgimtarët e fisit K marrin përsipër çdo pretendim që mund të lindë nga tezja lidhur me pasurinë, Komisioni çmon t’i konsiderojë këto të ardhura në analizën financiare të nënës së subjektit.

Lidhur me të ardhurat nga aktmarrëveshja nr. *** rep., datë 29.4.2003

19.85 Trupi gjykues ka analizuar dhe vlerësuar provën e depozituar nga subjekti pas kalimit të rezultateve të hetimit shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.9.2023, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila informon se bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 11 (pikat 2 dhe 3) “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, si dhe në udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, tatimi paguhet përpara kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk regjistron pasurinë pa u provuar pagimi i tatimit duke e konsideruar atë bindëse në këtë proces.

19.86 Pas prapësimeve, në vlerësim të dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues, në lidhje me pasurinë apartament të dhuruar nga nëna subjektit të rivlerësimit Suela Salavaçi, ka arritur në konkluzionin se: *Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe prova të mjaftueshme lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të prindërve për blerjen e apartamentit në Tiranë në shumën 38.800 USD, dhuruar subjektit në vitin 2013, duke provuar bindshëm mundësitë e tyre financiarë për blerjen e apartamentit në Tiranë në vitin 2005.*

19.87 Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave.

20. Apartament me sipërfaqe 84 m², në Golem.

20.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se apartamenti është porositur nga babai, sipas deklaratës noteriale datë 8.2.2005 dhe kontratës së porosisë datë 8.10.2010, pasuri kjo ende e paregjistruar.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

20.2 Komisioni ka verifikuar përmes sistemit multifunksional të ASHK-së, sipas të cilit nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme të regjistruara në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kavajë.

20.3 Nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se subjekti Suela Salavaçi ka nënshkruar në cilësinë e porositëses kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2012, me sipërmarrës A.K (i përfaqësuar me prokurë nga shoqëria “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor F. Ç) dhe shoqërinë ndërtuese “****”, përfaqësuar nga administratori K.Rr.

20.4 Objekti i kësaj kontrate është ndërtimi i një apartamenti 2+1, me sipërfaqe të përgjithshme 90.5 m², në katin e tretë të banimit, në Golem, Kavajë, kundrejt çmimit 72.000 euro. Në kontratën e porosisë palët kanë përcaktuar se afati i përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të ambienteve është 30.6.2012, ndërsa referuar librezës së energjisë elektrike pagesat e konsumit të energjisë kanë filluar në prill të vitit 2014.

Lidhur me mënyrën e likuidimit të apartamentit

20.5 Në kontratën e porosisë datë 20.3.2012, palët kanë përcaktuar se çmimi i blerjes së apartamentit është në vlerën 72.000 euro, e cila do të paguhet me këste, si vijon:

- kësti i parë në vlerën 37.000 euro është shlyer në datën 8.10.2010, në mbështetje të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2010, pa asnjë pretendim të mëtejshëm financiar nga palët;
- kësti i dytë në vlerën 25.000 euro është likuiduar nga shtetasi P.S në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate në datën 20.3.2012;
- kësti i tretë në vlerën 2.000 euro do të shlyhet deri në datën 15.5.2012;
- kësti i katërt në vlerën 2.000 euro do të shlyhet me daljen e dokumentacionit të pronësisë nga ZVRPP-ja Kavajë;

- vlera 6.000 euro do të konsiderohet e likuiduar, si vlerë mobilimi e apartamentit të mëparshëm të porositur nga shtetasi P.S, referuar kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2010, apartament i kthyer sipërmarrësit.

20.6 Në lidhje me pagesat e kryera për këtë pasuri, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar: *“Pagesat e kryera për blerjen e apartamentit janë: 20.000 euro në datën e nënshkrimit të deklaratës noteriale, kësti tjetër prej 17.000 euro është likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë për blerjen e apartamentit 2+1, ndërsa në momentin e nënshkrimit të kontratës së porosisë datë 20.3.2012 është paguar shuma prej 25.000 euro dhe kësti i fundit prej 2.000 euro është paguar në datën 15.5.2012, sikurse është përcaktuar në kontratë”*.

20.7 Subjekti ka depozituar dokumentacionin përkatës për apartamentin, si dhe mandatpagesat e kryera, duke theksuar faktin se të gjitha pagesat janë kryer nga babai i saj.

20.8 Referuar shpjegimeve të subjektit dhe akteve në dosje, kanë rezultuar faktet si vijon:

i) Përmes deklaratës noteriale nr. *** rep., datë 8.2.2005, të nënshkruar nga shtetasi P.S dhe A.Ç, ky i fundit deklaroi se ka marrë nga shtetasi P.S shumën 20.000 euro, si këst i parë për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 63 m² (1+1), në katin e parë të banimit, në Golem, Kavajë, me vlerë totale 31.500 euro, ndërsa diferenca e çmimit prej 11.500 euro do të paguhej në vijim.

ii) Përmes kontratës së porosisë datë 8.10.2010 të lidhur midis shtetasi P.S me sipërmarrësit F.Ç e A.A (të përfaqësuar me prokurë nga z. A.Ç), ku objekti i kësaj kontrate ishte ndërtimi i një apartamenti (2+1) me sipërfaqe totale 84 m² në katin e parë të banimit, në godinën nr. *, kundrejt çmimit 40.000 euro. Në kontratë përcaktohet se vlera 37.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe diferenca prej 3.000 euro do të shlyhej në momentin e legalizimit të banesës.

iii) Nga aktet në dosje evidentohet edhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2011, e nënshkruar nga shtetasi P.S dhe sipërmarrësi F.Ç (i përfaqësuar me prokurë nga z. A.Ç), përmes së cilës babai i subjektit deklaroi se pasi të ketë rregulluar të gjitha marrëdhëniet financiare me investitorin do të heqë dorë nga e drejta e pronësisë së apartamentit 2+1, duke ia kaluar vajzës Suela Salavaçi. Gjithashtu, rezervon të drejtën për ndërrim të këtij apartamenti, pasi të ketë shlyer detyrimet financiare të parashikuara në kontratën e porosisë datë 8.10.2010, duke ia kaluar vajzës Suela Salavaçi.

iv) Për sa më sipër, është lidhur kontrata e porosisë nr. ***, datë 20.3.2012, për apartamentin me çmim 72.000 euro, midis subjektit Suela Salavaçi, sipërmarrësit A.K (përfaqësuar nga z. F.Ç) dhe subjektit ndërtues “***” sh.p.k.

20.9 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se në vitin 2006 babai ka ndërruar apartamentin 1+1, me një apartament 2+1, duke shtuar edhe një vlerë, pasi apartamenti 1+1 kushtonte 31.500 euro, kurse apartamenti 2+1 kushtonte 40.000 euro. Më tej, subjekti ka shpjeguar se apartamenti i porositur nga babai në vitin 2010 është këmbyer me një apartament tjetër me vlerë 72.000 euro, sipas kontratës së porosisë datë 20.3.2012, duke njohur shumën e paguar deri në datën e nënshkrimit të kontratës dhe investimin e kryer prej prindërve të saj për mobilimin e apartamentit.

20.10 Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2022, të lëshuar nga shtetasi A.Ç, si përfaqësues i sipërmarrësit F.Ç, i cili, ndër të tjera, deklaroi se vlera 20.000 euro e shlyer nga shtetasi P.S për apartamentin 1+1 në bazë të deklaratës datë 8.2.2005 kaloi për prenotimin e apartamentit 2+1, për të cilin është lidhur kontrata e porosisë në datën 8.10.2010. Gjithashtu, ky shtetas deklaroi se apartamenti 1+1, objekt i deklaratës noteriale, i është shitur një shtetaseje tjetër, për të cilën ka depozituar kopje të kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2009. Më tej, z. Ç deklaroi se në datën 8.10.2010 u likuidua vlera 17.000 euro nga shtetasi P.S dhe në datën 20.3.2012 ka nënshkruar një kontratë porosie, ku shtetasi P.S ka lënë apartamentin objekt të kontratës së porosisë datë 8.10.2010, duke prenotuar një apartament me sipërmarrësin A.K, përfaqësuar po nga shtetasi A.Ç, ku detyrimet për këtë apartament janë shlyer sipas përcaktimeve në këtë kontratë.

20.11 Komisioni ka kërkuar informacion pranë shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. lidhur me çdo praktikë të nënshkruar pranë kësaj shoqërie, si dhe pagesat e kryera për blerje pasurie të paluajtshme nga subjekti Suela Salavaçi dhe babai i saj P.S.

20.12 Nga informacioni dhe dokumentacioni i ardhur nga shoqëria ndërtuese ka rezultuar se pagesat janë kryer me këste nga z. P.S (babai), përmes mandatpagesave përkatëse si vijon:

- i) mandat arkëtimi nr. *** (nr. **), datë 8.2.2005, për pagesën e shumës 20.000 euro nga shtetasi P.S, me përshkrimin “Blerje të një ap. në M. R, G, Kavajë”;
- ii) mandat arkëtimi nr. **, datë 8.10.2010, për pagesën e shumës 17.000 euro nga shtetasi P. S, me përshkrimin “Kësti i dytë i një ap. në M. R, G, Kavajë”;
- iii) mandat arkëtimi nr. **, datë 20.3.2012, për pagesën e shumës 25.000 euro nga shtetasi P. S me përshkrimin “Likuidim kësti për ap. tek M. R 2+1”;
- iv) mandat arkëtimi nr. **, datë 15.5.2012, për pagesën e shumës 2.000 euro, me përshkrimin “Likuidim kësti i ap. tek M. R (A.K)”;
- v) mandat arkëtimi nr. *, datë 20.3.2012, për pagesën e shumës 6.000 euro nga shtetasi P. S, me përshkrimin “Mobiliet e marra tek ap. 2+1, P.S”. Lidhur me këtë shumë, në kontratë palët kanë përcaktuar se ajo është likuiduar nga porositësja, si mobilim i apartamentit të mëparshëm të porositur nga babai në datën 8.10.2010, apartament i cili i është kthyer sipërmarrësit. Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë periudhën kur është kryer mobilimi i apartamentit me shumë 6.000 euro nga babai, për të cilën subjekti ka shpjeguar se mobilimi i apartamentit i porositur sipas kontratës datë 8.10.2010 është bërë në vite dhe në mungesë të deklarimeve periodike vjetore nuk mund të përcaktojë saktë periudhën se kur prindërit kanë shpenzuar për mobilim.

Lidhur me kredinë bankare të marrë nga nëna pranë ish-NBG Bank, në vitin 2010

20.13 Nga verifikimi i llogarive bankare të nënës së subjektit ka rezultuar marrja e një kredie prej saj, znj. L.S, në shumën 2.5 milionë lekë pranë ish-NBG, ku këstet e kësaj kredie janë shlyer nga subjekti. Komisioni i ka kërkuar subjektit të deklarojë se për çfarë qëllimi është përdorur kjo kredi, si dhe të depozitojë kopje të kontratës së kredisë.

20.14 Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se nga informacioni që ka marrë nga ABI Bank kredia është kredi konsumatore dhe është disbursuar në datën 11.1.2010 dhe është shlyer totalisht në datën 10.11.2014.

20.15 Subjekti ka shpjeguar se duhet të jetë përdorur në funksion të kontratës së porosisë nr. ***, datë 8.10.2010, për apartamentin në Golem, Kavajë. Shumat e derdhura në bankë në disa raste janë kryer prej saj për të lehtësuar veprimet e nënës për shlyerjen e disa kësteve të kredisë dhe kanë si burim të ardhurat e nënës.

Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit

20.16 Komisioni ka verifikuar vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë për vitin 2012, referuar çmimit të EKB-së, ku në qytetin e Kavajës ku ndodhet apartamenti i blerë nga subjekti, vlera e tregut të lirë është 58.575 lekë/m² dhe për apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme 90.5 m² çmimi i apartamentit duhet të ishte 5.301.037 lekë, ndërsa subjekti e ka blerë në vlerën 72.000 euro, duke mos u konstatuar problematika.

20.17 Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me të gjitha palët kontraktore (investitorët F.Ç dhe A.A të përfaqësuar nga A. Ç, sipërmarrës A.K i përfaqësuar nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe F.Ç, si dhe subjekti ndërtues “****” sh.p.k., i përfaqësuar nga z. K.Rr).

20.18 Nga përgjigjet e ardhura nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, ku subjekti ka ushtruar detyrën e saj, ka rezultuar se shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur një çështje penale të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por kjo çështje nuk është hetuar nga prokurorja Suela Salavaçi.

Komisioni ka hetuar lidhur me burimet e krijimit për apartamentin në Golem

a) Të ardhurat nga qiradhëniet

20.19 Në datë 28.9.2005 është lidhur kontrata e qirasë midis qiramarrësit Ambasada e Francës në Tiranë dhe qiradhënësve bashkëpronarë të përfaqësuar nga z. K.G (mbajtës i shumicës së prokurave) për dhënien me qira të objektit, për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar nga data 1.1.2006, me qira mujore 9.000 euro, e cila do të paguhej me xhirim bankar në llogarinë e hapur nga përfaqësuesi K.G në emër të trashëgimtarëve të Dr. S pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë. Nga kjo marrëdhënie qiraje duket se nëna e subjektit ka përfituar 1/72 e të ardhurave të qirasë, referuar aktit të trashëgimisë.

20.20 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se në fund të vitit 2006 kjo kontratë qiraje me Ambasadën e Francës është ndërprerë dhe në datën 23.1.2007 është lidhur kontrata me shoqërinë “****” sh.p.k, kundrejt qirasë mujore prej 9.000 euro. Më pas, në datën 12.1.2008 është nënshkruar një deklaratë noteriale, ku palët kanë rënë dakord që afati i kontratës të jetë deri në 6-mujorin e parë të vitit 2008. Pas kësaj date, ndërmjet palëve ka qenë e lidhur edhe një kontratë tjetër qiraje për periudhën 17.6.2009 – 17.6.2010. Sipas subjektit, shuma e të ardhurave nga qiraja është arkëtuar *cash*.

20.21 Në dosje janë administruar aktet si vijon:

i. Kontratë qiraje datë 23.1.2007, vërtetuar nga noteri me nr. *** rep., nr. ***kol., datë 23.1.2007, me qiradhënës bashkëpronarët S (të përfaqësuar nga z. K.G, mbajtës i prokurave të bashkëpronarëve që zotërojnë 55% të të gjithë pronës) dhe qiramarrës shoqëria ndërtuese “A-***” sh.p.k. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e godinës (ish-rezidenca e Ambasadës Franceze), e cila fillon në datën 1.1.2007 me qira mujore 9.000 euro dhe do të paguhej një herë në tre muaj (nga 27.000 euro) në numrin e llogarisë së z. K.G pranë Bankës Ndërkombëtare Tregtare. Palët kanë përcaktuar se kjo kontratë qiraje përfundon 6 muaj nga data e përfundimit të gjyqit në Apel, kohë që është e nevojshme për blerjen e pronës dhe likuidimin e bashkëpronarëve sipas pjesës së tyre në aktin e trashëgimisë me sip. 2.677 m², me çmim 1.180 euro/m².

ii. Përmes deklaratës së vërtetuar nga noteri me nr. *** rep., datë 12.1.2008, palët kontraktore deklarojnë shtyrjen e afatit të kontratës së qirasë për një afat 6-mujor, çka tregon se kjo marrëdhënie qiraje ka vijuar deri në qershor 2008. Komisioni ka administruar në dosje të dhëna bankare të ardhura nga Union Bank⁴ (shoqëria përthithëse e Bankës Ndërkombëtare Tregtare), ku duket se në llogarinë e përfaqësuesit të trashëgimtarëve K.G janë depozituar pagesa qiraje, që i përkasin vitit 2008. Sa më sipër, në analizë janë reflektuar të ardhura nga qiraja për vitin 2008, në shumën 184.774 lekë.

iii. Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. ***kol., datë 17.6.2009, me qiradhënës trashëgimtarët e Dr. S (të përfaqësuar me prokurë të posaçme nga K.G) dhe qiramarrës A.M për dhënien me qira të truallit dhe godinës⁵ 3-katëshe (ish-Ambasada Franceze), me qëllim përdorimin e saj nga qiramarrësi për ushtrim biznesi. Afati i kësaj qiraje fillon nga data 17.6.2009 deri më 17.6.2010, me vlerë 9.000 euro/muaj. Qiraja do të paguhet një herë në tre muaj.

20.22 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se për këtë marrëdhënie qiraje trashëgimtarët e Dr. S kanë qenë në proces gjyqësor për shkak se ky i fundit nuk ka paguar qiranë e dy tremujorëve, sipas kontratës datë 17.6.2009.

20.23 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 9.3.2016, ndër të tjera, i ka vendosur detyrimin qiramarrësit të dëmshpërblejë trashëgimtarët për objektin e marrë me qira.

20.24 Komisioni, bazuar në rrethanat sa më sipër, ku sipas vendimit gjyqësor provohet se trashëgimtarët nuk kanë përfituar të ardhura nga qiradhënia për periudhën janar – qershor të 2010. Për këtë arsye nuk janë reflektuar në analizë të ardhura nga qiraja për këtë periudhë.

20.25 Lidhur me të ardhurat nga kjo qiradhënie, Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë pagesën e detyrimeve tatimore në kuptim të ligjit, për të cilën subjekti ka shpjeguar⁶ se ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2022, ka informuar se e ka të pamundur të identifikojë ndonjë transaksion të kryer nga

⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 21.6.2023.

⁵ Pasuri e regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë sipas vërtetimit hipotekor të lëshuar në datën 22.7.2003, me nr. *** regjistri hipotekor, datë 24.10.1996, pasuria truall me sip. 2.869 m², mbi të cilin është ndërtuar një godinë 3 kat (Ambasada e Francës). Sipas dokumentit hipotekor, për këtë pasuri, nëna e subjektit, znj. E.S, ka 1/72 pjesë takuese.

⁶ Përgjigjet e subjektit të depozituara në datën 12.12.2022 ndaj pyetësorit datë 18.11.2022.

individët për periudhën e kërkuar për shkak se nuk ka një sistem unik për këto lloj tatimesh për t'i mbajtur jashtë sistemit informatik.

20.26 Sipas shpjegimeve të subjektit, objekti ishte dhënë me qira për ushtrim aktiviteti tregtar nga qiramarrësi A.M dhe nga të dhënat e marra nga QKB-ja rezultuan se disa shoqëri të këtij shtetasi të cilat kishin qendrën e ushtrimit të aktivitetit tek godina e ish-Ambasadës së Francës, ndërsa kontrata e qirasë ishte nënshkruar me përfaqësuesin e shoqërisë “A. A” sh.p.k.

20.27 Subjekti ka shpjeguar se i ka kërkuar informacion qiramarrësit, shoqëria “A. A” sh.p.k., e cila ka informuar se pagesat e tatimit në burim për qiranë janë paguar nga shoqëria sipas përcaktimeve të nenit 33 të ligjit nr. 8438, por nuk i kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues ligjor për të konfirmuar pagesat e kryera.

20.28 Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të saj, ka depozituar¹¹⁶ si dokumentacion provues:

- Kërkesë datë 21.11.2022 dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.11.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila konfirmon se duke mos pasur një sistem unik për këto lloj tatimesh të mbajtura jashtë sistemit informatik e ka të pamundur të identifikojë ndonjë transaksion të kryer nga këto biznese.
- Kërkesë datë 21.11.2022, drejtuar shoqërive ndërtuese “A. A” sh.p.k., “H-A” sh.p.k. dhe Universitetit Ndërkombëtar të Tiranës dhe shkresë kthim përgjigjeje datë 9.12.2022 e nënshkruar nga shtetasja A.B, përfaqësuese e shoqërisë “A. A” sh.p.k., e cila ndër të tjera konfirmon se: *“Ndërmjet palëve është lidhur kontrata nr. *** rep., nr.*** kol., datë 3.7.2009, notere D.K, ku në nenin 4 përcaktohet se bashkëpronarët e përfaqësuar me prokurë nga K.G dhe bashkëpronarët e përfaqësuar me prokurë nga J.V deklarojnë se janë plotësisht dakord që t'i shesin sipërfaqen e truallit prej 2.869 m² mbi të cilin është ndërtuar një godinë 3-katëshe ish-Ambasada Franceze”*. Sipas kësaj shkrese, në lidhje me këto kontrata, nga ish-shoqëria “A.A” sh.p.k. janë kryer pagesat për detyrimet ndaj përfaqësuesve me prokurë të trashëgimtarëve, si dhe detyrimet ndaj organeve tatimore, bazuar në nenin 33 të ligjit “Për tatimin e të ardhurave në burim”. Për shkak të ndërprerjes së aktivitetit të kësaj shoqërie shumë vite më parë, nuk disponohet dokumentacion.

20.29 Komisioni ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë e cila ka informuar se nga verifikimi i regjistrave të kontabilitetit dhe duke mos pasur një sistem unik për këto lloj tatimesh të mbajtura jashtë sistemit informatik e kanë të pamundur të identifikojnë ndonjë transaksion të kryer nga këto biznese apo individë për këto periudha.

20.30 Drejtorja Rajonale Tatimore ka informuar se nga verifikimet e kryera për znj. L.S, shtetasin A.M dhe subjektin “A-A” sh.p.k. nuk disponojnë deklarime dhe pagesa lidhur me tatimin në burim për periudhën e qiradhënies. Gjithashtu, DRT-ja ka informuar se për shtetasin K.G (përfaqësuesi i qiradhënësve), duke mos pasur një sistem unik, e kanë të pamundur të identifikojnë transaksionet për tatimin në burim për periudhën 2003 – 2007.

20.31 Në vijim, Komisioni ka kërkuar informacion më të detajuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, nëse ka detyrime tatimore të paguara nga shtetasja L.S për periudhën nga 2003 – 2016,

ku jemi informuar se nuk ka deklarime dhe pagesa të kryera për llogari të organit tatimor për këtë periudhë.

b) Të ardhurat nga kontrata e shitjes datë 14.1.2010, në shumën totale 502.000 euro⁷

20.32 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e një pasurie përmes kontratës së shitjes nr. ***rep., nr. ** kol., datë 14.1.2010, të lidhur midis 48 bashkëpronarëve/shitës, ku palë është edhe znj. E.S, dhe blerësve P.U, N.U, A.Sh dhe E.Sh.

20.33 Objekti i kësaj kontrate është shitja e një trualli⁸ me sip. 670 m² dhe ndërtesë me sip. 181 m², ndodhur në rrugën “M.M”, Tiranë, kundrejt vlerës totale 502.500 euro⁹.

20.34 Në lidhje me pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2023, të nënshkruar elektronikisht nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug dhe dokumentacionin¹⁰ mbështetës, ku provohet pagesa e tatimit për këtë kontratë.

20.35 Nga shitja e kësaj pasurie, nëna e subjektit ka përfituar shumën 20.938 euro, e cila është reflektuar në analizën financiare kumulative.

Analiza financiare

20.36 Komisioni ka analizuar mundësitë financiare të prindërve për blerjen e apartamentit në shumën 72.000 euro, duke konsideruar të ardhurat familjare të tyre, sipas viteve ku provohen pagesat e kësteve në vijim:

- Në analizën financiare të vitit 2010 janë reflektuar të ardhurat e prindërve, si dhe investimet e kryera gjatë këtij viti, duke marrë në konsideratë faktin se në fund të vitit 2009 prindërit kanë pasur një gjendje të akumuluar kursimesh në shumën 3.086.413 lekë. Kjo shumë është reflektuar në analizë financiare. Gjithashtu, nga verifikimi i të dhënave në llogaritë bankare duket se prindërit e subjektit kanë tërhequr nga bankat një shumë rreth 660.000 lekë, si dhe kanë siguruar të ardhura nga shitja e një pasurie në muajin janar 2010.

20.37 Pas analizimit të të gjithë informacionit të administruar në dosje mbi të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve, nga analiza financiare për vitin 2010, për pagesën në shumën 23.000 euro, ka rezultuar një balancë pozitive.

20.38 Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa duket se nga analiza financiare e kryer për blerjen e apartamentit në Golem ka rezultuar një balancë negative për pagesën e dy kësteve, në shumën 6.39 milionë lekë.

⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme (truall dhe ndërtesë), palë shitëse 48 bashkëpronarë dhe palë blerëse P.U, N.U, A.Sh dhe E.Sh, të një sipërfaqeje truall prej 670 m² + ndërtesë me sipërfaqe 181 m² në shumën totale 502.500 euro (pjesa takuese e E.S ***).

⁸ Kjo pasuri është përfituar nga nëna bazuar në: (a) dëshminë e trashëgimisë datë 7.8.1993 për trashëgimlënësen E.S (bashkëshortja e S.S), ku nëna e subjektit L.S trashëgon 1/30 ose 16/480 pjesë të pasurisë trashëgimore; (b) vendimin nr. **, date 6.4.2001, për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronares E.S, me objekt kthimin e pronave 3 shtëpive në rrugën “M.M”.

⁹ Në kontratë përcaktohet se pala blerëse merr përsipër likuidimin e taksës së shitjes dhe taksës së regjistrimit të kësaj pasurie.

¹⁰ Dokumentacion i dërguar me email datë 9.6.2023.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

20.39 Në prapësime, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim referuar sa më lart në apartamentin e Tiranës, duke pretenduar se të ardhurat e prindërve që rrjedhin nga pasuritë e trashëguara janë të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit dhe, si të tilla, duhet të përfshihen në analizën financiare progresive të rishikuar, duke e shtrirë atë mbi pasuritë e dhuruara dhe shumat e të hollave monetare të dhuruara në përputhje me ligjin.

Vlerësimi i Komisionit

20.40 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

- Në vlerësim të deklaratimeve në deklaratën *Vetting*, si dhe mbështetur edhe në dokumentacionin e administruar për këtë pasuri, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë apartamentin në Golem dhe ka depozituar dokumentacion ligjor të plotë, për të provuar burimet e ligjshme të prindërve për blerjen e pasurisë. Komisioni, pas vlerësimit përfundimtar të provave, duke i konsideruar të ardhurat që rrjedhin nga pasuritë e trashëguara të prindërve si të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit, pas reflektimit të tyre në analizën e përgjithshme kumulative të prindërve, ka rezultuar se ata kanë disponuar burime të ligjshme për krijimin e pasurisë në përputhje me dispozitat ligjore dhe kushtetuese nga qiradhënia e objektit (ish-Ambasada e Francës) për periudhën 2007 – 17.6.2010.

20.41 Në analizë të arsytimit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke mbajtur në konsideratë se sipas praktikës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, detyrimin për ta mbajtur dhe paguar tatimin në burim e ka shoqëria (ligji nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 8, pika 1, shkronja “d”, i ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006, i ministrit të Financave, paragrafi 2.6.3).

20.42 Trupi gjykues vlerëson se nëna e subjektit u provua nga hetimi administrativ se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për pagesën e kësteve në vitin 2005 dhe 2010 për blerjen e kësaj pasurie, duke analizuar dokumentacionin, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti. Nga analiza financiare pas prapësime, ka rezultuar një balancë negative në shumën 686.784 lekë për pagesën e këstit në vitin 2012.

20.43 Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjekti janë bindëse lidhur me mundësinë financiare të prindërve të saj për krijimin e kësaj pasurie, duke arritur në përfundimin se nga hetimi u krijua bindja se prindërit kanë pasur mundësi të investojnë në këtë pasuri të paluajtshme dhe se nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

21. Gjendje *cash* në shumën 10.000 euro, me burim nga shitja e një pasurie të paluajtshme

21.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* në shumën 10.000 euro ka si burim të ardhurat nga shitja e një pasurie të paluajtshme me kontratën e premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2012, të lidhur ndërmjet shitësve trashëgimtarë të shtetasit K.K, midis të cilëve është edhe nëna e subjektit L.S, dhe blerësit shoqëria “K” sh.p.k.

21.2 Objekti i kësaj kontrate është pasuria tokë truall me sip. 700 m² në bregdetin e Jalës, Vuno, Vlorë, ku shitësit janë trashëgimtarët e shtetasit K.K, të cilët pretendojnë se janë bashkëpronarë sipas vendimit nr. akti **, datë 13.9.1993, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve.

21.3 Referuar kontratës, çmimi i shitjes (truall dhe objektet mbi të) është në vlerën 84.000 euro. Gjatë hetimit nga të dhënat bankare pranë BKT-së rezulton se ka kaluar pagesa e shumës prej 14.500 euro, në datën 10.4.2015, nga shtetasja A. A (e autorizuar nga shoqëria “K” sh.p.k., me autorizimin e datës 10.4.2015¹¹), me përshkrimin “Derdhje në llogari sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol.”. Nga verifikimi i akteve, ekstremitetet e kontratës në përshkrimin e derdhjes në bankë përputhen me aktin kontratë shitblerjeje nga e cila buron kjo pagesë.

21.4 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shumën 14.500 euro në BKT, të ardhura me burim nga kontrata nr. *** për shitjen e një prone në emër të nënës L.S.

Konstatime të Komisionit për gjendjen *cash* në shumën 10.000 euro

21.5 Lidhur me gjendjen *cash* në shumën 10.000 euro, të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, me burim shitjen e një pasurie të paluajtshme sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2012, Komisioni, nisur nga fakti se prona objekt shitjeje nuk është pasuri e regjistruar dhe, për pasojë, nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore, në përputhje me nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës, konstaton se duket se gjendja *cash* nuk është krijuar me burime të ligjshme.

21.6 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

21.7 Lidhur me pasurinë truall të ndodhur në Jalë, e cila është objekt i kësaj kontrate, subjekti ka shpjeguar se palët ende nuk kanë nënshkruar kontratën përfundimtare të shitblerjes së këtij trualli, pasi ende nuk është kryer azhurnimi i zonës dhe lëshimi i certifikatave të pronësisë.

21.8 Në lidhje me faktin nëse duhet paguar detyrim tatimor për këtë të ardhur, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

- Shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.9.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila informon se bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 11 (pikat 2 dhe 3) “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, si dhe udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, tatimi paguhet përpara kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk regjistron

¹¹ Autorizim i depozituar nga subjekti pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 20.2.2023.

pasurinë pa u provuar pagimi i tatimit. Sa më sipër, DPT-ja informon se të ardhurat e përfituara sipas kontratës premtim shitjeje do të taten në momentin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme.

21.9 Subjekti ka prapësuar se me depozitimin në ASHK të kontratës së shitjes apo dhurimit lind detyrimi për të paguar tatimin. Tatimi përllëgaritet nga vetë sistemi i ASHK-së dhe nuk mund të realizohet kalimi i pronësisë pa u paguar tatimi sipas ligjit. Gjithashtu, subjekti referon edhe vendimin nr. 29, datë 21.7.2022, të Kolegjit, që ka trajtuar gjerësisht një rast të ngjashëm dhe ka vendosur se detyrimi për të paguar detyrimin tatimor lind në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes dhe regjistrimit të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

21.10 Për sa më sipër, subjekti kërkon që vlera e arkëtuar të njihet si e ardhur e ligjshme. Gjithashtu, subjekti pretendon që në analizën financiare të Komisionit të përfshihet edhe shuma prej 5.000 euro, sipas konfirmimit të dhënë nga daja i saj S.G, i cili së bashku me vëllain tjetër, të ndjerin K.G, i kanë dhuruar motrës së tyre L.S shumën 2.500 euro secili. Pra kërkon përfshirjen në analizën financiare të shumës 14.500 euro, përfituar nga kjo kontratë.

Vlerësimi i Komisionit për gjendjen *cash* në vlerën 10.000 euro

21.11 Komisioni, nisur nga sa më lart arsyetuar, nuk krijoi dyshime lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

21.12 Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë dhe sa në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar shumën *cash* 10.000 euro, me burim nga kontrata e premtim shitjes. Në analizë të rrethanave faktike, si dhe të argumenteve të subjektit në prapësime në raport me legjislacionin e zbatueshëm, referencat ligjore të cituara në shkresën e DPT-së parashikojnë se tatimi mbi fitimin për pasuritë e paluajtshme të paregjistruara paguhet në momentin e regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme pranë ZVRPP-së, sot ASHK.

21.13 Pavarësisht këtyre parashikimeve, duke qenë se kontrata e premtim shitjes i përket vitit 2012, Komisioni vlerësoi të nevojshme t'u drejtohet parashikimeve ligjore në kohën e lidhjes së kësaj kontrate.

21.14 Sipas legjislacionit tatimor të kohës, dhe konkretisht sipas parashikimit të nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe aktit nënligjor në zbatim të tij, pra udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, në pikën 2.7.3 të tij parashikohet se: *“Tatimi mbi të ardhurat nga kalimi i të drejtës së pronësisë paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. Derdhja bëhet para kryerjes së regjistrimit të sendeve të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme mbledhin tatimin lidhur me kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe e derdhen atë brenda 10 ditëve nga kryerja e veprimeve në llogarinë e administratës tatimore”*.

21.15 Bazuar në sa më sipër, vërehet se detyrimi për të paguar detyrimin tatimor do të lindte në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes dhe regjistrimit të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Në kushtet kur kontrata përfundimtare e shitblerjes nuk është lidhur ende, siç

rezultoi nga hetimi i kryer i Komisionit, nuk ka lindur ende detyrimi i nënës (apo i trashëgimtarëve) për të paguar detyrimin tatimor.

21.16 Në përfundim, Komisioni e vlerëson si një burim të ligjshëm shumë të kaluar me transaksion bankar (nëse në analizë merret vetëm pjesa takuese e nënës prej 9.500 euro balanca nuk ndryshon), duke e konsideruar se nuk ka lindur ende detyrimi për pagesën e tatimit për këto të ardhura nga kontrata e premtim shitjes, për rrjedhojë duhet të reflektohet në analizën kumulative të prindërve.

21.17 Komisioni konkludon se plotësohen kërkesat e nenit 32, pika 4, për garantimin e ligjshmërisë së krijimit të shumës së përfituar nga nëna nëpërmjet kontratës së premtim shitjes, duke e konsideruar këtë shumë si burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

22. Depozitat dhe llogaritë dyemërore bashkëmbajtëse të subjektit me prindërit

22.1 ABI Bank ka konfirmuar disa llogari bankare në emër të subjektit dhe prindërve të saj, ku ndër të tjera evidentohen: (a) një llogari depozite në monedhën dollar në emër të znj. Suela Salavaçi, e hapur në datën 11.6.2003 dhe e mbyllur më 1.2.2010; (b) një llogari depozite në monedhën dollar në emër të shtetasës L.S, e hapur në datën 4.2.2005 dhe e mbyllur më 17.4.2019. Ndërsa shtetasi P.S ka qenë gjithashtu bashkëmbajtës i llogarive të shtetasës L.S.

22.2 Referuar lëvizjeve të llogarive ka rezultuar se kemi të bëjmë me një depozitë të çelur në vitin 2003. Kjo shumë ka kaluar në një depozitë tjetër, e cila është shtuar në vite me interesat e kredituara në këtë llogari dhe deri në vitin 2014 ishin në shumën 65.864 USD, pasi mbyllet kjo llogari më pas kalon në BKT.

22.3 BKT-ja ka informuar mbi disa llogari bashkëmbajtëse në emër të shtetasve Suela Salavaçi dhe P ose L.S, ku ndër të tjera evidentohet edhe llogaria bankare në monedhën dollar në emër të L ose Suela Salavaçi, e çelur në datën 12.11.2014.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

22.4 Referuar të dhënave bankare të administruara në bankë ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur likuiditete në bankë, duke filluar nga viti 2001. Në vitin 2003 ka një shtesë të konsiderueshme, pasi shuma totale e depozituar gjatë këtij viti në llogari ka rezultuar rreth 11.000 lekë dhe në vitin 2004 gjendja e llogarive shkon në shumën totale rreth 14.1 milionë lekë.

22.5 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se llogaria bankare është hapur nga prindërit e saj në datën 4.2.2005, pranë NBG Bank, me gjendje në shumën 52.534 USD dhe në datën 17.12.2012 subjekti është bërë bashkëmbajtës në këtë llogari dhe nuk ka kontribuar në hapjen e saj, ku gjendja e llogarisë në këtë datë, 17.12.2012, ka qenë në shumën 63.504 USD.

22.6 Në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar depozitën bankare në shumën 52.000 euro, me pjesë takuese 0%, ku tek seksioni “Data dhe viti i krijimit të pasurisë” ka deklaruar “*Në vitin 2003 depozitë në emër të babait P.S*” dhe në DPV-në e vitit 2012, tek rubrika e “Të dhënave konfidenciale” ka deklaruar se është mbajtës e tretë e një llogarie tek NBG Bank me prindërit.

22.7 Nga të dhënat bankare pranë ABI Bank (ish-NBG) ka rezultuar se në llogarinë e subjektit Suela Salavaçi në monedhën dollar është kryer depozitim *cash* i shumës 52.000 USD, në datën 11.6.2003, e cila është vendosur në depozitë me afat në datën 13.6.2003.

22.8 Në datën 4.2.2005 kjo depozitë në shumën 52.534 USD (ku përfshihen edhe interesat) është tërhequr dhe depozituar pranë NBG Bank në llogarinë e depozitës së nënës L.S. Në datën 28.9.2011 shtohet si bashkëmbajtës në llogarinë e depozitës P.S dhe, më tej, në datën 2.11.2012 shtohet bashkëmbajtëse në llogari edhe subjekti Suela Salavaçi, për shumën e depozitës 63.504 USD.

22.9 Gjendja e depozitës bankare prej 65.864 USD është tërhequr në datën 12.11.2014 nga NBG Bank dhe depozituar në të njëjtën datë pranë BKT-së. Më tej, në datën 21.11.2016, në llogari janë kredituar interesat e përfituara nga kjo depozitë në shumën 1.696,5 USD dhe gjendja e llogarisë (depozitë + interes) në datën 21.11.2016 paraqitet në vlerën 67.496 USD.

Analiza e burimit të krijimit

22.10 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj depozite bankare të ardhurat e familjes nga kontratat e qirave, shitja e pasurive të paluajtshme, të ardhura nga vëllai në Itali etj.

22.11 Gjatë hetimit subjekti ka saktësuar se: *“Referuar dokumentacionit që disponoj, të ardhurat që shërbyen për krijimin e depozitës në shumën 52.534,94 USD janë të ardhurat familjare që prindërit e mi kishin realizuar deri në atë moment nga qiraja e pasurisë tek ish-Ambasada Franceze, të ardhurat nga puna sezonale në Greqi, të ardhurat sipas aktmarrëveshjes dhe të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme”.*

22.12 Komisioni ka analizuar këto të ardhura, të cilat gjenden të trajtuara në vijim të këtij vendimi.

22.13 Komisioni i ka kërkuar subjektit dokumentacion mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait në Itali, si dhe të saktësojë masën e kontributit në krijimin e pasurive, për të cilin subjekti ka shpjeguar se ka depozituar në deklaratën *Vetting* dokumentacion justifikues ligjor për një pjesë të vogël të të ardhurave të realizuara nga puna e vëllait ndër vite dhe gjatë përshkrimit të burimeve të krijimit që shërbyen për krijimin e pasurive të luajtshme (likuiditete) dhe të paluajtshme ka dashur të identifikojë të gjitha të ardhurat e realizuara nga familjarët e saj, për aq sa ka pasur dijeni në atë moment, pavarësisht shumës së tyre.

22.14 Subjekti deklaron se është e vështirë për të dhe familjarët e saj të përcaktojnë saktësisht sa ka qenë shuma e kontributit në krijimin e depozitës edhe nga të ardhurat e vëllait, kjo pasi prindërit dhe vëllai i saj nuk kanë qenë asnjëherë subjekte deklaruese dhe nuk kanë pasur dhe ruajtur të dhëna për kronologjinë dhe masën e kontributit nga vëllai, pasi kontributi i tij nga emigracioni ka qenë minimal, të cilin nuk mund ta përcaktojë.

22.15 Më tej, subjekti ka shpjeguar se vëllai është kthyer nga Italia në vitin 2008 dhe që nga ajo kohë dhe aktualisht jeton dhe punon në Tiranë, në Bankën e Shqipërisë. Sipas subjektit një pjesë e të ardhurave të realizuara nga puna në Itali kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit që ai ka në bashkëpronësi me bashkëshorten. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se

vëllai ka paraqitur kërkesën pranë autoriteteve në shtetin italian nëpërmjet *email*-it të tij personal, në datën 17.10.2022, të cilit i është kthyer përgjigje që mund të aksesojë *link*-un e vendosur në dispozicion, por që ende sot nuk ka arritur të gjenerojë informacionin personal për këto të ardhura.

22.16 Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhura nga vëllai i subjektit në analizën financiare.

Analiza financiare

22.17 Komisioni ka analizuar mundësitë financiare të prindërve të subjektit për krijimin e depozitës bankare në vitin 2003, duke analizuar të ardhurat që nga viti 1999. Në këtë analizë nuk janë reflektuar të ardhurat nga qiradhënia dhe shitja e pasurive, për të cilat nuk u provuan pagesat e detyrimeve tatimore, në përputhje me nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

22.18 Lidhur me balancën negative të rezultuar nga analiza, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

22.19 Lidhur me shumën 52.000 USD të depozituar në datën 11.6.2003, përmes prapësimeve të datës 20.9.2023, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 18.8.2003, e nënshkruar nga znj. Suela Salavaçi (akt i cili është dorëzuar pranë ILDKPKI-së në përgjigje të procesverbalit datë 7.7.2016), ku subjekti deklaron se së bashku me babain kanë depozituar shumën 52.000 USD në NBG Bank, dega Tiranë, me nr. llogarie **** datë 13.6.2003. Ky depozitim të ardhurash është bërë edhe në emrin e saj, pasi gjendja shëndetësore e babait është e rënduar dhe nuk ka pasur mundësi që ai vetë apo dikush tjetër më i afërt të kryente veprime me bankën.
- Urdhër nr. ***, datë 11.7.2004, të ministrit të Mbrojtjes të kohës, ku babai i subjektit, oficer në pension, dërgohet për trajtim dhe kurim mjekësor në Turqi, fakt i cili provon se babai i saj ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore.

22.20 Subjekti ka shpjeguar se me ardhjen në Shqipëri të nënës së saj çdo veprim bankar bëhej prej saj, pasi shumën e depozituar i përkiste asaj. Kjo llogari është çelur disa muaj përpara se të emërohej në detyrën e prokurores dhe nuk ka kontribut në krijimin e kësaj depozite, fakt të cilin e ka deklaruar në deklaratën noteriale të vitit 2003, në deklaratimet e tjera periodike, si dhe deklaratën *Vetting*. Subjekti sqaron se prindërit nuk janë në cilësinë e personit tjetër të lidhur në krijimin e kësaj pasurie në vitin 2003.

22.21 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se me ndarjen nga jeta të babait P.S, përmes dëshmisë së trashëgimisë ligjore datë 5.2.2021 janë caktuar trashëgimtarë ligjorë në mënyrë të barabartë: subjekti, nëna dhe vëllai i saj, me 1/3 pjesë të pasurive trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe detyrimet përkatëse të trashëgimlënësit.

22.22 Subjekti saktëson se në lidhje me llogaritë e babait të saj të krijuara në formën e depozitës ka përfituar 1/3 pjesë takuese, vetëm për efekt të ligjit si trashëgimtarë ligjore dhe duke qenë pasuri e ardhur nga trashëgimia, me burim të qartë dhe nëpërmjet llogarisë bankare, subjekti

pretendon se nuk mund të hetohet dhe të kalohet barrë prove nga Komisioni për justifikimin e kësaj vlere, e cila duhet të konsiderohet për efekt të ligjit si pasuri e ligjshme.

22.23 Subjekti ka shpjeguar se vëllai E.S i ka përfutur edhe pjesën e nënës, duke përfutur gjithsej 2/3 pjesë të pasurisë në depozita. Veprimet bankare për transferimin e shumës janë kryer në korrik të vitit 2021 dhe deklaruar këto transaksione në DPV-në e vitit 2021.

22.24 Lidhur me këtë fakt, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

- Vendim për lëshimin e trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.2.2021.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.6.2021, e nënshkruar prej saj dhe e përdorur për ta paraqitur pranë BKT-së, ku ka deklaruar se pranë kësaj banke ka depozitë bankare në monedhën dollar me të ndjerin, babain P.Si, e cila ka qenë e përbashkët vetëm për veprime bankare, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore të tij. Më tej, subjekti deklaroi se në lidhje me këtë depozitë nuk ka kryer asnjëherë asnjë veprim bankar, pasi kjo depozitë është vetëm e tij dhe, për këtë arsye, heq dorë nga posedimi i këtyre likuiditeteve dhe në bazë të dëshmisë së trashëgimisë datë 5.2.2021 kjo llogari të kalojë në pronësi të trashëgimtarëve ligjorë në pjesë të barabartë.
- Konfirmime të lëshuara nga BKT-ja në datën 13.9.2023, të cilat konfirmojnë gjendjen e llogarive të subjektit, nënës dhe vëllait të saj, të shoqëruara me *statement* bankar për secilin, ku evidentohen kalimet e shumave monetare sipas pjesës takuese të dëshmisë së trashëgimisë datë 5.2.2021, me trashëgimlënës P.S; nxjerrje llogarie e shtetasit P.S të lëshuara nga Credins Bank, datë 13.9.2023, ku evidentohen kalimet e shumave sipas aktit të trashëgimisë.

22.25 Sipas subjektit, nga këto akte provohet se nuk ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie dhe gjithashtu pretendon se prindërit nuk janë në cilësinë e personave të tjerë të lidhur dhe nuk duhet t'i kalonte barrë prove mbi mundësinë financiare në krijimin e depozitës.

Vlerësimi i Komisionit lidhur me depozitën e hapur në qershor të vitit 2003

22.26 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

- Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit në prapësime, si dhe fakteve të rezultuara gjatë hetimit, i çmon të drejta pretendimet e subjektit, nisur nga faktet se: (i) kjo depozitë është krijuar para se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit; (ii) subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 depozitën bankare me kontribut 0%, me përshkrimin “Depozitë në emër të babait”; (iii) subjekti ka provuar këtë fakt edhe përmes deklaratës noteriale datë 18.8.2003, sipas së cilës deklaroi se së bashku me babain kanë depozituar shumën 52.000 USD në NBG Bank, dega Tiranë, me nr. llogarie ***, datë 13.6.2003.

22.27 Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë faktin që kjo depozitë është krijuar përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit, dhe sa rezultoi nga hetimi administrativ lidhur me të ardhurat e nënës gjatë gjithë jetës së saj nga pasuritë e paluajtshme, në referim të rrethanave ato nuk duhet të ndikojnë në analizën e përgjithshme financiare të subjektit të rivlerësimit apo në konkluzionin e përgjithshëm mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur.

23. Depozitë në BKT në emër të Suela Salavaçit ose P.S, hapur në datën 10.4.2015, në shumën 1.680.000 lekë.

23.1 Subjekti ka deklaruar si burim nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit nr. ***, datë 15.10.2012 dhe vendimit të Gjykatës së Lartë datë 17.10.2014, shumën 1.680.000 lekë, të derdhur nga Bashkia Tiranë.

23.2 Nga hetimi nuk u konstatuan problematika.

24. Llogaritë e vajzave K dhe K.M

24.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar gjendjen e llogarisë në emër të vajzës K M, në shumën 11.652 USD pranë Intesa Sanpaolo Bank. Subjekti deklaroi se llogaria bankare e vajzës K.M është hapur në vitin 2004, në shumën fillestare 2.000 USD nga nëna dhe shtesat ndër vite janë bërë po nga nëna. Intesa Sanpaolo Bank ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie bankare.

24.2 Gjithashtu, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar gjendjen e llogarisë në emër të vajzës K.M në shumën 6.462 USD pranë Credins Bank. Kjo llogari është hapur në vitin 2011 në shumën fillestare 1.000 USD nga nëna e subjektit dhe shtesat ndër vite janë bërë prej saj. Si burim krijimi janë deklaruar të ardhurat e familjes.

24.3 Credins Bank ka konfirmuar gjendjen e kësaj depozite, e cila përputhet me deklaratimet e subjektit.

24.4 Komisioni ka administruar procesverbalet e shpjegimeve të dhëna nga subjekti pranë ILDKPKI-së, ku, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se burimi i këtyre të ardhurave janë dhuratat që i ka bërë vajzave çdo ditëlindje. Sipas subjektit, derdhet në këto depozita janë në datat e përafërta me ditëlindjet e tyre dhe kryesisht të derdhura nga nëna. Subjekti ka deklaruar se nuk janë deklaruar shtesat, pasi kanë qenë në vlera të ulëta.

24.5 Komisioni ka analizuar të ardhurat progresive të prindërve, nga ku duket se prindërit nuk kanë pasur mundësi për depozitime në llogaritë e vajzave, pasi kanë rezultuar me balanca negative në vite.

24.6 Në lidhje me këtë konstatim nga Komisioni, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

24.7 Lidhur me depozitat bankare në emër të vajzave, subjekti ka shpjeguar se nëna e saj çdo vit ka depozituar shumën të ndryshme monetare në llogaritë e tyre, si dhurata për ditëlindje. Nëse shtrirja e analizës financiare do të ishte në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë, objekt dhurimi, duke përfshirë shpenzimet për të përballuar

kostot e jetesës, prindërit do të rezultojnë me mundësi financiare për dhurimin e shumave. Subjekti ka shpjeguar se përveç depozitimeve të kryera nga nëna edhe vëllai i saj E.S ka depozituar në llogaritë e vajzave respektivisht shumat 800 euro në datën 21.8.2015 dhe 800 euro në datë 22.8.2015. Subjekti depozitoi dokumentacion mbështetës lidhur me shumat e depozituara në llogaritë e vajzave.

Vlerësimi i Komisionit për depozitat e vajzave

24.8 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratat e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

- Komisioni analizoi mundësinë e prindërve dhe referuar analizës kumulative të prindërve për periudhën 2004 – 2016, pas prapësimeve ka rezultuar me balanca pozitive, pasi u morën në konsideratë të ardhurat që rrjedhin nga pasuritë trashëgimore të nënës, sa më sipër trajtuar.

- Komisioni e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit, pasi përmes dokumentacionit të paraqitur ka provuar të ardhurat e ligjshme të nënës, si dhe dhurimin e kryer nga vëllai i saj.

25. Automjeti i blerë në datën 15.5.2014

25.1 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të luajtshme në deklaratën *Vetting*.

25.2 DPSHTRR-ja ka informuar se znj. Suela Salavaçi ka pasur të regjistruar automjetin me targë AA *** AR.

25.3 Nga verifikimi i dosjes së mjetit ka rezultuar se subjekti në cilësinë e blerëses ka nënshkruar me shitësin/qiradhënësin “L” sh.a. dhe qiramarrësin “A.M”, person fizik, një kontratë kalimi të drejtash dhe shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.5.2014, për blerjen e automjetit tip “Nissan Juke 1.6 Acenta”, me vit prodhimi 2011, në vlerën 6.690 euro.

25.4 Sipas kësaj kontrate, qiramarrësja A.M ka kaluar tek blerësi Suela Salavaçi të drejtën/kredinë për ta blerë automjetin me çmimin 6.690 euro. Gjithashtu, qiradhënësi/shitësi “L” sh.a. miraton kalimin e kredisë dhe shet automjetin tek blerësi Suela Salavaçi kundrejt kësaj vlere, e cila është përcaktuar të paguhet në llogarinë bankare të shitësit. Automjeti është shitur në datën 6.4.2017, në vlerën 700.000 lekë.

Lidhur me çmimin e blerjes së automjetit

25.5 Nga aktet e administruara në dosje rezultojnë se shoqëria “L” sh.a. ka kryer zhdoganimin e automjetit në datën 10.5.2011, ku sipas faturës së zhdoganimit vlere e mjetit është 12.308 euro + zhdoganimi në vlerën 350.531 lekë, ndërsa subjekti e ka blerë 3 vjet më pas në vlerën 6.690 euro.

25.6 Nisur nga ky fakt, Komisioni ka kërkuar pranë shoqërisë “L” sh.a. dosjen e dhënies me qira financiare të mjetit tek qiramarrësja A.M dhe më pas kalimi i këtij detyrimi financiar tek subjekti. Në përgjigje, shoqëria “L” sh.a. ka konfirmuar këtë marrëdhënie qiraje financiare, duke

informuar se nuk disponon dosjen e plotë të dhënies, pasi ka kaluar afati i ruajtjes së dokumentacionit.

25.7 Komisioni ka administruar kontratat e qirave financiare të nënshkruara para noterëve, nga ku ka rezultuar se detyrimi i mbetur i pashlyer i shtetases A.M ndaj kompanisë “L” sh.a. ka qenë në shumën 7.147 euro, në datën 24.3.2014, referuar akteve dhe në datën 15.5.2014 është likuiduar nga subjekti detyrimi financiar i mbetur në shumën 6.690 euro, duke i kaluar subjektit pronësia e këtij automjeti.

25.8 Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasen A.M, ku nga përgjigjet e mbërritura nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Tiranë nuk rezultoi që në ngarkim të kësaj shtetaseje të jenë regjistruar procedime penale.

25.9 Komisioni ka kryer analizën mbi mundësitë për blerjen e automjetit në maj të vitit 2014, duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit mbi burimet (me të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit në vite), të përlogaritura në tabelën mbi analizën vijuese.

25.10 Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

- Duket i paqartë çmimi i blerjes së automjetit në vlerën 6.690 euro, e cila përfaqëson vlerën e mbetur të detyrimit financiar të shtetases A.M për këtë automjet.
- Nga analiza financiare për blerjen e automjetit duket se ka rezultuar një balancë negative në shumën 620.459 lekë, deri në momentin e blerjes së automjetit, referuar rezultateve paraprake të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

25.11 Lidhur me çmimin e blerjes së automjetit, subjekti ka shpjeguar se “A.M”, person fizik, ka nënshkruar me shoqërinë “L” sh.a. një kontratë qiraje financiare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.7.2011, për blerjen e automjetit në çmimin 16.900 euro, përfshirë TVSH-në, nga e cila ka parapaguar 3.380 euro dhe 13.520 euro janë financuar nga qiradhënësi “L” sh.a.

25.12 Në vijim, midis shoqërisë “L” sh.a., në cilësinë e qiradhënësit, dhe shtetases A.M, në cilësinë e qiramarrësit, është lidhur një kontratë e dytë qiraje financiare nr. *** rep., nr.*** kol., datë 24.3.2014, për të cilën subjekti nuk e ka të qartë arsyen e lidhjes së kësaj kontrate të dytë, por duke iu referuar përmbajtjes së saj rezulton se kontrata e qirasë është me afat pezullues (në kuptim të neneve 89 dhe 90/1 të Kodit Civil), i cili fillon në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe mbaron në datën 25.3.2014, afat brenda të cilit qiramarrësi duhet të paguante në llogarinë bankare të qiradhënësit shumën 633,87 euro.

25.13 Sipas subjektit, duket se palët nuk kanë respektuar detyrimet ndërmjet tyre dhe, për këtë arsye, kanë lidhur këtë kontratë qiraje financiare me afat. Gjithashtu, referuar ekstraktit të QKB-së rezulton se aktiviteti i biznesit të qiramarrëses “A.M”, person fizik, ka pasur probleme financiare dhe likuiditeti, pasi në datën 10.6.2014 është barrë siguroese mbi titujt e pronësisë të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore.

Subjekti mendon se për këto arsye palët kanë rënë dakord të prishin kontratën e qirasë dhe shoqëria “L” sh.a. të shesë automjetin.

25.14 Subjekti ka argumentuar se shoqëria “L” sh.a. ka për objekt ushtrimin e veprimtarisë së qirasë financiare dhe nuk është në objektin e saj shitja e automjeteve dhe krijimi i fitimit nga shitblerja e automjeteve, pasi përfitimet ekonomike i realizon nga interesat e qirasë. Për këtë arsye, subjekti mendon se shitja e automjetit në çmimin 6.690 euro është sa detyrimi i mbetur nga qiramarrësi. Vlera 6.690 euro është detyrim i mbetur nga qiraja financiare, e cila amortizohet sipas ligjit. Nëse qiramarrësi do të paguante edhe këtë vlerë, automjeti do të kalonte në pronësi të tij, ndaj edhe shoqëria “L” sh.a. e ka vlerësuar dhe caktuar këtë çmim (6.690 euro). Në kushtet kur personi fizik nuk ka pasur mundësi të paguajë këstin mujor të qirasë financiare, vërtetuar nga kontrata e dytë e lidhur midis palëve, ka marrë si kosto diferencën ndërmjet vlerës së mbetur të automjetit në pasqyrat financiare me vlerën e kalimit të së drejtës në vlerën 6.690 euro.

25.15 Sa i përket balancës negative të rezultuar nga analiza financiare e Komisionit, subjekti ka prapësuar se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat familjare dhe për të ardhurat e realizuara për harkun kohor 1 janar – 15 maj 2014 rezulton se të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit janë pothuajse sa vlera e blerjes së automjetit.

25.16 Për këtë arsye, në datën e blerjes së automjetit, përveç kursimeve të realizuara nga të ardhurat nga paga, kanë shërbyer si burim krijimi edhe kursimet gjendje *cash*.

25.17 Subjekti pretendon se përfshirja e këtyre burimeve është në harmoni me deklaratimet e saj në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe me logjikën e përdorur nga subjekti.

25.18 Subjekt thekson faktin se nga qëndrimi tashmë i konsoliduar i Kolegjit pasaktësitë në deklaratime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

25.19 Sipas subjektit, kursimet *cash* gjatë vitit 2014 kanë qenë në shumën 500.000 lekë dhe bazuar në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 7.7.2016 gjendja e kursimeve *cash* në fund të vitit 2014 ka qenë në shumat 1.000.000 lekë dhe 5.000 euro e, për rrjedhojë, kursimet *cash* në fund të vitit 2013 kanë qenë në shumat 500.000 lekë dhe 5.000 euro. Në vijim të shpjegimeve të saj, subjekti pretendon se në datën e blerjes së automjetit, 15.5.2014, ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin.

Vlerësimi i Komisionit për automjetin

25.20 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

25.21 Lidhur me çmimin e blerjes së automjetit, Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit, nisur nga faktet dhe rrethanat e çështjes, si:

- Nga hetimi administrativ nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe qiramarrëses A. M. dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ngrëjë dyshime lidhur me ndonjë trajtim preferencial në çmimin e blerjes së automjetit.

- Automjeti i blerë në vitin 2011 është përdorur 3 vjet dhe duke konsideruar amortizimin e tij trupi gjykues ka vlerësuar se argumentet e subjektit janë bindëse.

- Sa i përket balancës negative, nisur nga shpjegimet e subjektit Komisioni ka reflektuar në analizë financiare gjendjet e kursimeve *cash* të saktësuara nga subjekti. Për rrjedhojë, analiza financiare për vitin 2014 pas prapësimeve ka rezultuar me balancë pozitive.

26. Lidhur me banesën e prindërve në rrugën “D.B”

26.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë banimi rrugën “D.B”, Tiranë, në pronësi të babait, e formalizuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.10.2016. Referuar kësaj deklarate noteriale, babai i subjektit P.S, ndër të tjera, deklaroi se vajza së bashku me familjen e saj jetojnë prej vitit 1998 në banesën e tij (truall dhe objekt 2-katësh në rrugën “D.B”), pa shpërblim.

26.2 Nga verifikimi i deklarimeve periodike nga viti 2003 deri aktualisht, subjekti ka deklaruar si adresë banimi “Rr. “D.B”, nr. **, Tiranë” ose “Rr. “E.F”, nr. **, Nj. Adm. **”, e cila përkon me adresën e banesës së prindërve të saj.

26.3 Bashkëshorti i subjektit, z. B.M, në vitet 2003 dhe 2004 ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së për shkak të funksionit të tij si zv/drejtor në Drejtorinë QFMT pranë Ministrisë së Rendit Publik, ku në deklaratimet e tij në vitet 2003 dhe 2004 ai ka deklaruar të njëjtën adresë banimi “Rr. “D.B”, nr. **, Tiranë”.

Komisioni hetoi lidhur me banesën në rrugën “D.B”

26.4 ASHK Tirana Veri ka konfirmuar pasurinë truall me sip. 303.6 m² dhe ndërtesë me sip. 125 m², në rrugën “E.F” (e quajtur “D.B”) Tiranë, me nr. ***, vol. *, f. **, z. k. ***, e regjistruar në pronësi të znj. Suela Salavaçi.

26.5 Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë ka rezultuar se mbi këtë truall shtetasi P.S ka ndërtuar një banesë dykatëshe, për të cilën është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 7.10.2011, për godinë banimi 2-katëshe me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 262.7 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 125 m².

26.6 Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të pasurisë, ka rezultuar se babai i subjektit P.S, përmes kontratës së shitjes nr. ***, datë 10.3.2004, ka blerë nga shtetasi M.Gj një sipërfaqe trualli prej 303.6 m² nga sipërfaqja totale e pasurisë së shitësit prej 4.137 m² (nga e cila trualli i lirë me sip. 2.136,5 m² dhe truall i zënë me ndërtime pa leje bashkë me oborret e tyre me sip. 2.950 m²), në vlerën 1.700.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

26.7 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se vlera e blerjes së truallit është likuiduar me këste nga viti 1997 dhe i likuiduar përfundimisht në datën e lidhjes së kontratës. Sipas shpjegimeve të subjektit, mbi këtë pasuri ndodhet banesa private 2-katëshe e ndërtuar nga prindërit e saj, ku kati

përdhe me sip. 125 m² është ndërtuar në vitet 1997 – 1998, ndërsa kati i parë, i cili është papafingo me sipërfaqe ndërtimi 143 m², është ndërtuar në vitet 2010 – 2011.

26.8 Subjekti ka saktësuar se ka qenë muaji shtator i vitit 1998 (jo viti 2004), ku familja e saj është transferuar për të banuar në banesën e ndërtuar nga prindërit, ndodhur në rrugën “D.B”, sot rruga “E. F” ku edhe jetojnë aktualisht. Subjekti ka depozituar pamje fotografike të pronës me ortofoto për vitet 1994, 1999, 2003, 2004, 2007, 2009, 2012 dhe 2015, ku në vitin 1999 evidentohen gjurmë të banesës.

26.9 Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë periudhën e ndërtimit të banesës 2-katëshe, si dhe të dokumentojë vlerën e investimit (situacion punimesh) në këtë pasuri.

26.10 Subjekti ka shpjeguar se nuk disponon situacion punimesh, pasi ato janë kryer nga prindërit e saj në mënyrë informale, si dhe ka kaluar një kohë e gjatë.

26.11 Subjekti ka paraqitur si provë një raport vlerësimi të hartuar në nëntor të vitit 2022 nga një eksperte vlerësuese e pasurive të paluajtshme, ku ka paraqitur një situacion punimesh ndërtimi të katit të parë (përdhe) me sip. 125 m² në vitin 1997, e cila është përcaktuar në shumën 1.705.488 lekë, ndërsa vlera e investuar për katin e dytë (kati i parë në gjuhën teknike, papafingo) me sip. 143 m² (sip. 125 m² + sip. 17.93 m² verandë) është përcaktuar nga ekspertja në vlerën 2.829.065 lekë. Sipas këtij raporti, vlera totale e pasurisë është 4.534.553 lekë - 10% (kostot operationale) = 4.081.098 lekë, ku përlllogaritja e tyre është kryer bazuar në çmimet e zërave ndërtimore të vitit 1995 nga Enti Kombëtar i Banesave për katin e parë dhe çmimet e EKB-së sipas VKM-së Nr. 708, datë 12.10.2011, për katin e dytë.

26.12 Komisioni, lidhur me zhvillimin e pronës ndër vite nga aktet e administruara në dosje praktika e legalizimit të banesës të ardhur nga ASHK-ja, si dhe pamjeve fotografike të printuara nga *Google Maps*, vlerësoi faktet si vijon:

- i) Me kontratën e shitjes datë 10.3.2004, babai i subjektit ka blerë truallin me sip. 303.6 m², në vlerën 1.700.000 lekë.
- ii) Referuar formularit të vetëdeklarimit nr. ***, datë 20.3.2005, babai i subjektit ka kryer vetëdeklarim për legalizimin e objektit informal “shtëpi banimi”, me sipërfaqe të zënë 303.6 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 175 m² dhe ka deklaruar ndërtimin e një kati banimi, me datë ndërtimi 10.10.1998.
- iii) Nga informacioni i ardhur nga FSHU-ja identifikohet një abonent në emër të shtetasit P. S në Tiranë, ku sipas të dhënave në sistemin e faturimit kontrata e furnizimit me energji elektrike është lidhur në datën 17.11.2000, në kategorinë familjare.
- iv) Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 24.3.2011, Drejtoria Rajonale e ALUIZN-it Tiranë ka konstatuar se numri i kateve mbi tokë është “2 kate” (kati i parë është 133.1 m², duke përfshirë edhe verandën 8.1 m² dhe kati i dytë është 143 m²).
- v) Përmes deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.9.2011, shtetasi P.S ka deklaruar se nga matjet faktike të kryera nga ALUIZNI Tiranë sipërfaqja e truallit mbi të

cilin është ndërtuar objekti rezulton të jetë më pak se 262.7 m², pasi pjesa tjetër e truallit është marrë nga Bashkia Tiranë për zgjerimin e rrugës.

- vi) Në datën 5.9.2011 janë kryer pagesa përkatëse të legalizimit të objektit (tarifës së shërbimit dhe ndikimit në infrastrukturë) pranë ALUIZNI-t Tiranë, në vlerën totale 44.414 lekë.
- vii) Në datën 7.10.2011 është lëshuar leja e legalizimit nr. ***, datë 7.10.2011, për godinë banimi 2 kat me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 262.7 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 125 m².
- viii) Nga pamjet imazherike të printuara nga gjeoportali kombëtar ASIG, referuar pamjeve me ortofoto të pronës së vitit 1999, evidentohet gjurmë ndërtimi mbi truallin, si dhe nga pamjet ortofoto të viteve 2015 dhe 2018 duket çatia e ndryshuar, me ngjyrë tjetër.
- ix) Nga verifikimi i pamjeve fotografike të printuara nga *Google Maps* (në *website*) evidentohen gjurmë ndërtimi që në vitin 1999, ku në shkurt të vitit 2003 duket se është ndërtuar mur rrethues, në tetor të vitit 2004 duket se ka ndërtim të çatisë me të kuqe dhe në periudhën qershor 2009 – prill 2012 evidentohen gjurmë ndërtimi shtesë ku është ndryshuar çatia.

26.13 Nisur nga faktet e sipërcituara dhe për periudhat e ndërtimit bazuar në të dhënat e ofruara nga *Google Maps*, Komisioni ka konsideruar ndërtimin e një kati banimi me vit ndërtimi 1998, duke llogaritur koston e ndërtimit bazuar në çmimin referencë të EKB-së së viteve 1997 – 1998 për katin e parë me sip. 125 m² (pasi babai i subjektit ka vetëdeklaruar ndërtimin e katit të parë në vitin 1998) dhe koston e ndërtimit sipas EKB-së së viteve 2010 – 2011 për katin e dytë të ndërtimit, me sip. 143 m² (referuar pamjeve fotografike të printuara *Google Maps*).

26.14 Nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni, kostoja e ndërtimit sipas çmimeve referencë të EKB-së është rreth 6.9 milionë lekë për banesën 2-katëshe në Tiranë, e reflektuar në analizën financiare.

26.15 Komisioni analizoi mundësitë e prindërve për ndërtimin e banesës në rrugën “D.B”, Tiranë dhe referuar analizës progresive të prindërve të subjektit ka rezultuar se për investimin në vitin 2010 ata kanë pasur mundësi për ndërtimin e shtëpisë, ndërsa kanë rezultuar balanca negative për vitet 1997 – 1998 dhe 2011 në shumën totale 892.833 lekë.

26.16 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

26.17 Bazuar në prapësimet e subjektit në lidhje me shtrirjen e analizës financiare për personin tjetër të lidhur, prindërit do të rezultonin me mundësi financiare për ndërtimin e shtëpisë për vitet 1997 – 1998 dhe 2010 – 2011. Në lidhje me përlllogaritjen e investimit të kryer, subjekti i kërkon Komisionit që, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit¹² në përlllogaritjen e koston së ndërtimeve informale, duhet të korrektojë në zbritje në masën 10% vlerën e investimit.

Vlerësimi i Komisionit

¹² Vendim nr. 6, datë 17.3.2022, për subjektin e rivlerësimit H.K, paragrafi 14.8.

26.18 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

- Në lidhje me banesën në përdorim, pretendimi i subjektit në prapësime është për zbritje në masën 10% të vlerës së investimit të banesës.

26.19 Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit të paraqitura në prapësime, nga dokumentacioni i administruar nuk rezultoi ndonjë e dhënë që banesa të ishte ndërtuar nga një firmë ndërtimi.

26.20 Pas zbritjes në masën 10% të vlerës së investimit të banesës, referuar analizës kumulative të prindërve ka rezultuar me balanca pozitive deri në vitin 2011.

Analiza kumulative e prindërve pas prapësimeve

26.21 Komisioni hetoi lidhur mbi çdo investim të prindërve të subjektit, ku nga informacioni i ardhur nga ASHK Tirana Veri dhe DPSHTRR-ja nuk u evidentuan investime të prindërve në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, përveç atyre të trajtuara më sipër. Nga analiza përfundimtare e prindërve të subjektit rezultoi si vijon:

Analiza e prindërve pas prapësimeve

Periudha	Të ardhura	Shpenzime/pasuri	Rezultati në fund
1993 – 1996	2 711 427	464 568	2 246 859
1997 – 1998	3 699 452	3 213 590	485 861
1999 – 2003	25 979 509	12 024 279	13 955 230
2004	14 625 282	5 604 444	9 020 838
2005	9 640 571	6 597 625	3 042 946
2006	4 252 071	988 287	3 263 784
2007	4 405 388	1 707 720	2 697 668
2008	4 635 877	- 2 319 513	6 955 390
2009	8 766 020	2 864 780	5 901 239
2010	12 801 742	7 053 730	5 748 012
2011	7 002 615	4 753 730	2 248 885
2012	3 695 119	4 381 903	- 686 784
2013	1 071 165	1 006 257	64 908
2014	1 006 944	792 280	214 664
2015	4 556 821	3 469 895	1 086 926
2016	2 069 859	1 215 129	854 730

26.22 Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi financiare për investimin në pasuri të paluajtshme, në depozita dyemërore me subjektin apo për të dhuruar shumat e deklaruara nga subjekti për vajzat e saj.

26.23 Nga hetimi apo faktet e rezultuara nuk u ngritën dyshime që këto investime të jenë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA BASHKËSHORTI B.M

27. Apartament me sipërfaqe 74 m², në Kukës, pasuri në bashkëpronësi, blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa me kontratën e shitblerjes datë 29.6.1993.

27.1 Nga informacioni i ardhur nga ASHK Drejtoria Vendore Kukës, si dhe verifikimi i kryer në sistemin multifunksional të ASHK-së nuk ka rezultuar pasuri e paluajtshme e regjistruar në pronësi të shtetasit B.M.

27.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së, referuar përgjigjes së ZVRPP-së Kukës konfirmohet pasuria e paluajtshme nr. ***, apartament me sip. 74 m², e regjistruar në emër të shtetasit B.M, e përfituar nga kontrata e privatizimit.

27.3 Nga aktet e pronësisë të administruara në dosje rezulton se ky apartament është përfituar përmes privatizimit të banesave shtetërore, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.6.1993, të lidhur midis NKB Kukës dhe blerëses Sh.M (nëna e bashkëshortit), në vlerën 18.570 lekë.

27.4 Lidhur me këtë pasuri, në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së subjekti ka deklaruar se, megjithëse bashkëshorti figuron si bashkëpronar, kjo shtëpi në të cilën kanë jetuar prindërit e bashkëshortit është shitur që para vitit 1999, por nuk është bërë ende kontrata e shitjes. Sipas subjektit, megjithëse *de juro* kjo pronë figuron edhe në emër të bashkëshortit të saj, *de facto* posedohet nga persona të tjerë. Gjithashtu, subjekti sqaron se bashkëshorti i saj nuk ka përfituar asgjë nga shitja e këtij apartamenti.

27.5 Nga hetimi i kryer nuk rezultuan problematika lidhur me këtë pasuri.

28. Automjet tip “Dacia Duster”, blerë në datën 4.1.2012

28.1 Nga informacioni i ardhur nga DPSHTRR-ja konfirmohet se automjeti me targë AA *** CK ka qenë i regjistruar në pronësi të bashkëshortit të subjektit.

28.2 Nga aktet e administruara në dosje ka rezultuar se bashkëshorti M, përmes faturës tatimore nr. **, datë 4.1.2012, të lëshuar nga shoqëria “P” sh.p.k., ka blerë automjetin tip “Dacia Duster”, me vit prodhimi 2011, në vlerën 13.380 euro.

28.3 Ky automjet aktualisht nuk figuron në pronësi të z. M, pasi ai e ka shitur në datën 13.12.2018, në çmimin 7.400 euro.

28.4 Lidhur me burimin për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka shpjeguar se si burim kanë shërbyer kursimet e realizuara nga të ardhurat e saj dhe bashkëshortit gjatë vitit 2011, si dhe dhurimi nga nëna në shumën 6.000 euro po gjatë këtij viti. Në DPV-në e vitit 2011 bashkëshorti ka deklaruar shkëmbimin e automjetit, kursimet e vitit 2011 edhe dhurimin nga nëna e bashkëshortes.

28.5 Komisioni ka analizuar mundësitë financiare për blerjen e automjetit, sipas DPV-së së vitit 2011, në të cilën është deklaruar shkëmbimi i automjetit. Referuar analizës së përgjithshme ka rezultuar një balancë pozitive.

28.6 Nga hetimi i kryer nuk rezultuan problematika lidhur me këtë pasuri.

29. Lidhur me depozitimin e shumës 30.000 USD, të depozituar në datën 14.7.2005

29.1 Nga të dhënat bankare të dërguara nga Intesa Sanpaolo Bank ka rezultuar depozitim i një shume prej 30.000 USD në datën 14.7.2005.

29.2 Në deklarin periodik vjetor të vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *“Depozitë për efekt marrje vize, hapur në korrik 2005 dhe mbyllur në shtator 2005. Gjendja e dollarëve marrë hua dhe kthyer mamasë. Vlera e deklaruar 30.000 USD. Pjesa takuese 0%”*. Më tej, tek rubrika e të dhënave që nuk publikohen, subjekti ka deklaruar: *“Hapje mbyllje llogarie për efekt vize në Bankën Amerikane, korrik – shtator 2005”*.

29.3 Gjatë hetimit subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 25.10.2022, të lëshuar nga shtetasi S.G (vëllai i nënës së subjektit), i cili ndër të tjera deklaron se në fund të muajit qershor 2005 i ka dhënë hua pa interes motrës së tij L.S shumën 30.000 USD, e cila i duhej si garanci për pajisjen me vizë amerikane të vajzës së saj Suela Salavaçi. Z. G deklaron se kjo shumë i është kthyer në fillim të muajit tetor 2005.

29.4 Komisioni ka administruar procesverbalet e shpjegimeve të dhëna nga subjekti pranë ILDKPKI-së, ku, ndër të tjera, subjekti është pyetur lidhur me burimin e krijimit të shumës 30.000 USD të deklaruar në DPV-në e vitit 2005, për të cilën ka shpjeguar se burimi i të ardhurave janë të ardhurat nga pasuritë që disponojnë prindërit e saj, si dhe nga puna në emigracion.

29.5 Bazuar në DPV-në e vitit 2005, si dhe në deklarinet në ILDKPKI, Komisioni analizoi mundësinë e nënës për shumën 30.000 USD, referuar analizës kumulative sipas tabelës së përgjithshme në vitin 2005.

29.6 Nga hetimi i Komisionit duket se ka një mospërputhje në deklarinet e subjektit lidhur me shumën 30.000 USD gjatë hetimit. Nga analiza financiare kumulative prindërit e subjektit kanë rezultuar me balancë negative në vitin 2005. Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

29.7 Në prapësimet e saj subjekti ka shpjeguar se në vitin 2005, kur ka marrë hua shumën 30.000 USD nga nëna, nuk ka pasur dijeni mbi burimin që përdori nëna për sigurimin e shumës monetare. Për këtë arsye edhe në procesverbalin e ILDKPKI-së ka deklaruar të ardhurat e realizuara nga prindërit, pasi këtë informacion ka pasur në momentin e mbajtjes së këtij procesverbali.

29.8 Gjatë procesit të rivlerësimit, pasi subjekti ka diskutuar me nënën, ka konfirmuar me dajën S.G (deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2022) se shuma 30.000 USD i ishte

marrë atij hua për ta depozituar në llogari për efekt të marrjes së vizës. Kjo për arsye se në momentin kur është depozituar shuma nëna ka pasur të investuara dy depozitat me afat dhe nuk ka dashur të prishë interesat që do të përfitonte nga këto depozita.

29.9 Subjekti sqaron se shuma monetare është depozituar dhe tërhequr prej saj, pa u përdorur për ndonjë qëllim tjetër, përveç si ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005 dhe mospërputhja në deklaratimet e saj ka qenë për shkak të mangësisë në informacionin e disponuar, si në DPV-në e vitit 2005, ashtu edhe në momentin e mbajtjes së procesverbalit.

29.10 Në lidhje me analizën financiare, subjekti i kërkon Komisionit të përfshijë shumën e marrë hua nga daja S.G, të ardhurat e të cilit janë në të njëjtën masë me të ardhurat e realizuara nga nëna, si të ardhurat nga qiraja e ish-Ambasadës së Francës, ashtu edhe nga të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme, përkatësisht në vitet 2001 dhe 2002.

29.11 Gjithashtu, subjekti kundërshton analizën financiare progresive të kryer nga Komisioni, pasi ajo është shtrirë për çdo investim apo shpenzim të kryer nga prindërit, duke përfshirë edhe ndryshimin e gjendjes së likuiditeteve në bankë, sikurse prindërit të jenë persona të lidhur me subjektin.

Vlerësimi i Komisionit lidhur me shumën 30.000 USD për marrjen e vizës

29.12 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

- Lidhur me mospërputhjen në deklaratimet e subjektit, Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit në raport me faktet e rezultuara gjatë hetimit, i çmon bindëse shpjegimet e subjektit dhe arsyet e hapjes së kësaj llogarie dhe provueshmërinë e qëllimit të saj për pajisjen me vizë.

29.13 Sa më sipër, ky transaksion u vlerësua nga trupi gjykues se nuk duhet të ketë efekt në analizën financiare të subjektit gjatë vitit 2005.

30. Lidhur me verifikimet e deklaratimeve periodike vjetore ndër vite

30.1 Në DPV-në e vitit 2013, tek rubrika e të ardhurave, subjekti ka deklaruar pagesë si trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në shumën 1.489 USD. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura nga trajnime në shumën 2.000 euro.

30.2 Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion përfitimin e këtyre shumave apo *statement*-in bankar nëse janë marrë me bankë.

30.3 Subjekti ka shpjeguar se në vitin 2013 është angazhuar nga OPDAT-i në dy trajnime, ku viti i parë i tyre (të cilët më pas janë zhvilluar nga shkolla e Magjistraturës) është financuar nga OPDAT-i dhe pagesat i janë dhënë *cash*, por nuk ka dokumentacion të ruajtur. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se ka komunikuar me përfaqësues të OPDAT-it, por është informuar se aktualisht nuk janë më punonjës të këtij institucioni. Subjekti ka dërguar *email* për të konfirmuar prej tyre

këtë fakt, të cilët me *email*-in e datës 9.12.2022 kanë informuar se në sistemin e tyre të brendshëm nuk ka gjurmë për pagesa të bëra ndaj saj në vitin 2013.

30.4 Më tej, subjekti ka shpjeguar se në vitin 2015 ka marrë pjesë në trajnimin e zhvilluar nga *Organisation For Economic*, aktivitet për të cilin është paguar në shumën 1.190 euro, siç vërtetohet nga përshkrimi i bërë në kreditimet e llogarisë së saj bankare në Raiffeisen Bank (të depozituar pranë Komisionit), ndërsa për trajnimet e tjera të kryera gjatë këtij viti subjekti deklaron se nuk ka arritur të sigurojë të dhëna apo dokumentacion justifikues ligjor.

30.5 Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) pasqyrë kreditimi të Raiffeisen Bank për vitin 2015; (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 24.11.2022, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, e cila konfirmon se znj. Suela Salavaçi është paguar nga ky institucion për periudhën 2011 – 2019 si eksperte/pedagoge e jashtme; (iii) postë elektronike me *email*, dërguar tek OPDAT-i.

30.6 Në lidhje me të ardhurat e deklaruara sipas pikës iii, subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor, për këtë arsye këto të ardhura në vlerat 1.489 USD dhe 2.000 euro nuk janë konsideruar në analizë financiare për vitet 2013 dhe 2015.

30.7 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

30.8 Subjekti ka shpjeguar se gjatë hetimit administrativ ka bërë përpjekje për të marrë dokumentacion justifikues në lidhje me këto dy shuma, por nga komunikimi me përfaqësues të OPDAT-it, vendosur në dispozicion edhe të Komisionit, nuk ka arritur të sigurojë dokumentacion justifikues ligjor.

30.9 Për vitin 2015, subjekti ka arritur të sigurojë dokumentacion për trajnimin e zhvilluar nga OECD, aktivitet për të cilin është paguar në shumën 1.190 euro, sikurse vërtetohet nga përshkrimi i bërë në kreditimin e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank.

30.10 Në lidhje me këto të ardhura, subjekti deklaron se është në pamundësi për të siguruar dokumentacion, për sa kohë institucioni organizues nuk disponon gjurmë për pagesat e kryera.

Vlerësimi i Komisionit

30.11 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

- Nisur nga fakti se subjekti i ka deklaruar këto të ardhura në DPV, por nuk provoi marrjen e tyre apo pagimin e detyrimeve tatimore për to, Komisioni vlerëson se, pavarësisht se subjekti provon punësimin apo përfitimin e të ardhurave, këto nuk mund të konsiderohen të ligjshme në kuptim të ligjit e, për pasojë, nuk mund të reflektohen në analizën financiare.

31. Kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti ndër vite, të analizuara nga Komisioni

31.1 Nga verifikimi i deklarimeve periodike, subjekti ka deklaruar kursime nga paga, nga viti 2007 dhe në vijim.

31.2 Referuar shpjegimeve të subjektit të dhëna në procesverbalin e mbajtur në datën 7.7.2016 pranë ILDKPKI-së, ajo ka deklaruar se gjendja e kursimeve *cash* deri në datën 31.12.2014 është në vlerat 1.000.000 lekë dhe 5.000 euro.

31.3 Referuar deklarimeve të subjektit gjatë hetimit, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar kursime *cash* çdo vit. Nisur nga fakti që subjekti nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash*, këto gjendje të deklaruara në DPV-të ndër vite janë reflektuar si shtesë në analizën financiare.

Konstatime të Komisionit lidhur me kursimet *cash*

31.4 Duket se kursimet e deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike vjetore ndër vite nuk përputhen me gjendjen kumulative të kursimeve në vitet 2007 – 2016, të cilat duhet të ishin në vlerën 6.095.925 lekë, nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve.

31.5 Nga analiza financiare e përgjithshme e subjektit për periudhën 2007 – 2016, duket se kanë rezultuar balanca negative në vitet 2007, 2012, 2013, 2014 dhe 2015, të cilat shkojnë në shumën totale 6.229.990 lekë.

31.6 Nuk provohet burimi i ligjshëm i gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

31.7 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

31.8 Në lidhje me deklarimin e kursimeve në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka shpjeguar se i është referuar kursimeve të depozituara në llogarinë rrjedhëse dyemërore pranë Intesa Sanpaolo Bank. Pra, kursimet nga paga në vitin 2007, në shumën 400.000 lekë, nuk kanë qenë *cash*, por kanë qenë të kursyera në llogari bankare.

31.9 Në lidhje me deklaratimet periodike në vitin 2008 dhe në vijim, subjekti sqaron Komisionin se gjendja *cash* nuk përputhet, për arsye se në çdo DPV ka deklaruar gjendjen e kursimeve dhe jo shtesat, ndërsa Komisioni kursimet nga paga i ka konsideruar si shtesa të çdo viti, por në fakt kursimet e deklaruara kanë qenë gjendja e likuiditeteve të disponuara në fund të çdo viti (gjendje në banesë).

31.10 Subjekti shpjegon se referuar deklarimeve të saj për çdo vit, metodologjia e deklaratimit ka qenë e njëjtë, duke deklaruar kursimet nga paga, të cilat përfaqësonin kursimet *cash* në banesë ose shtim në llogari bankare me burim pagat. Subjekti prapëson se në asnjë rast nuk rezulton që të ketë deklaruar shtim të pasurisë duke përdorur si burim gjendjen *cash*, sipas metodologjisë së përdorur nga Komisioni. Përdorimi i kursimeve *cash* ka qenë vetëm në masën e deklaratimit të gjendjes së kursimeve në fund të çdo viti.

31.11 Sipas subjektit, nëse gjendja e kursimeve do të ishte sipas metodologjisë së trajtuar nga Komisioni, qoftë edhe në një rast, do të kishte deklarime që kursimet *cash* i kanë shërbyer për

shtimin e ndonjë pasurie apo përballimin e ndonjë shpenzimi. Ndërkohë, si në DPV, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar asnjëherë gjendje *cash*. Subjekti pretendon se gjendja kumulative e kursimeve në shumën 6.095.925 lekë nuk tregon gjendjen reale të kursimeve të deklaruara.

31.12 Subjekti thekson faktin se gjithmonë ka deklaruar kursimin e vitit si likuiditet (*cash* ose në llogari bankare), sikurse është analizuar edhe në rastin e blerjes së automjetit në vitin 2011 (faturë e lëshuar në datën 4.1.1012) dhe disa herë kjo gjendje *cash* është përdorur si burim krijimi për shtimin e pasurisë ose është përdorur në përballimin e shpenzimeve të kryera gjatë vitit.

31.13 Ndërsa, sa i përket deklarimeve të saj në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja se gjendja *cash* në fund të vitit 2014 ka qenë 1.000.000 lekë dhe 5.000 euro, subjekti shpjegon se ky deklarim është lapsus dhe vjen nga përllogaritja e gabuar e gjendjes, duke u kthyer prapa në kohë.

Vlerësimi i Komisionit për kursimet *cash*

31.14 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyetën si vijon:

- Në analizë të prapësimeve të subjektit lidhur me gjendjen e kursimeve *cash*, çmori të konsiderojë pretendimet e subjektit, si dhe deklaratimet në seancë, duke e rishikuar analizën financiare, duke i konsideruar si gjendje likuiditetesh në fund të vitit.

32. Lidhur me dhuratat e deklaruara ndër vite

32.1 Në deklaratimet periodike vjetore, subjekti ka deklaruar dhurata nga nëna, konkretisht: (i) në DPV-në e vitit 2007, dhuruar 6.000 euro; (ii) në DPV-në e vitit 2008, dhuruar 5.000 euro; (iii) në DPV-në e vitit 2010, dhuruar 10.000 euro; (iv) në DPV-në e vitit 2011, dhuruar 6.000 euro. Këto shuma janë reflektuar në analizën financiare të prindërve, sipas viteve përkatëse.

33. Shpenzime udhëtimi

33.1 Subjekti ka deklaruar në pyetësorin standard se disa nga udhëtimet e saj dhe të familjarëve jashtë shtetit janë financuar personalisht nga mikesha E.Gj, administratore e shoqërisë “G T”, udhëtime në të cilat ka qenë edhe znj. Gj dhe/ose familjarë të saj.

33.2 Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2020, të lëshuar nga shtetasja E.Gj, e cila, ndër të tjera, deklaron se me Suela Salavaçin ka marrëdhënie shumë të ngushta familjare, ku subjekti së bashku me familjarët e saj kanë qenë disa herë të ftuar nga znj. Gj, konkretisht në 3 udhëtime në Pragë, Dubai e Barcelonë, si dhe ka qenë e ftuar dhe është pritur prej saj në udhëtime në Amerikë, ku çdo shpenzim është përballuar prej saj.

33.3 Subjekti ka depozituar vërtetime të lëshuara në datën 7.10.2020 nga shoqëria “G.T”, ku vërtetohen paketat turistike, bileta apo rezervime hoteli të mbyllura në emër të znj. Suela Salavaçi gjatë periudhës 2004 – 2020, për vende të ndryshme, si dhe çmimi total i secilit udhëtim.

33.4 Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit, gjatë hetimit subjekti ka saktësuar se të gjitha paketat turistike drejt Antalias janë blerë pranë shoqërisë “G.T” sh.p.k., gjithashtu udhëtimet familjare të bëra me familjen e shtetasës E.Gj ose edhe vetëm apo me familjen e saj në SHBA janë përballuar prej saj për shkak të miqësisë familjare.

33.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në pyetësorin standard evidentohet se subjekti ka paraqitur vërtetime të lëshuara nga shoqëria “G.T”, të cilat konfirmojnë shpenzime të kryera për udhëtimet familjare të subjektit për gjithë periudhën 2004 – 2020. Komisioni, në analizën financiare për periudhën 2004 – 2016, nuk i ka marrë në konsideratë këto vërtetime, pasi nuk i përkasin periudhës kur janë kryer udhëtimet. Për rrjedhojë, këto shpenzime janë reflektuar në analizën financiare, sipas metodologjisë së Kolegjit në vendimin nr. 11, datë 22.5.2019.

33.6 Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me agjencitë turistike “G.T” sh.p.k. dhe “C.T” sh.p.k., si dhe administratorët/ortaket e këtyre shoqërive, znj. E.Gj dhe znj. A.G (L).

33.7 Nga përgjigjet e ardhura nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës nuk ka rezultuar ndonjë çështje penale e regjistruar në emër agjencive turistike apo administratoreve të saj. Nga hetimi nuk u evidentua ndonjë situatë konflikt interesi midis subjektit dhe agjencive turistike.

Konstatime të Komisionit

33.8 Duket se subjekti ka pranuar dhurata në vlerën totale rreth 8.446 euro, për udhëtimet e kryera gjatë periudhës 2009 – 2019, të cilat ndikojnë në sjelljen e magistratit jashtë detyrës.

33.9 Subjekti nuk i ka deklaruar këto dhurime në deklaratimet periodike vjetore, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion që provon ofertat me çmim promocional të përfituara nga agjencia turistike, për udhëtimet e kryera prej saj.

33.10 Shpenzimet për udhëtimet e kryera në periudhën 2004 – 2016 u përlllogaritën sipas standardit të Kolegjit, duke u reflektuar në analizën financiare sipas viteve.

33.11 Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33.12 Lidhur me këto konstatime të Komisionit, subjekti ka prapësuar se ato nuk janë në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, në vendimin nr. 11, datë 22.5.2019, në të cilin theksohet se: *“Në rastet kur nga subjekti i rivlerësimit provohet se shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë, atij/atyre do t’u llogariten vetëm sasia e të hollave të xhepit prej 5 eurosh/dollarësh amerikanë”*. Sipas subjektit, Kolegji orienton se në rastet kur shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga të tretë analiza financiare të mos rëndohet me shpenzime të pakryera. Ky vendim i Kolegjit është përdorur në vazhdim në përlllogaritjen e

shpenzimeve të udhëtimit në analizat financiare të kryera në Kolegj apo në Komision. Në vijim, subjekti ka referuar edhe vendimin nr. 02 të vitit 2023, si dhe vendimin nr. 26/2022 të Kolegjit, për rastin e subjektit të rivlerësimit E. Ll. Sipas subjektit, edhe vetë Komisioni në konstatimin e tij nuk përcakton se cili rregull ligjor apo etik është cenuar në rastin konkret, sepse nuk ka një të tillë.

33.13 Subjekti thekson faktin se: *“Në rastin konkret nuk jemi përpara një dhurimi, sepse sipas parashikimeve të nenit 761 të Kodit Civil dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale dhe në rastin konkret jemi përpara një shpenzimi të mbuluar për një shërbim, për të cilën unë as nuk kam pasur dijeni në lidhje me vlerën e shpenzuar”.*

33.14 Subjekti ka shpjeguar se familja e saj ka marrëdhënie të ngushta miqësore me përfaqësuesit e shoqërisë “G.T” sh.p.k. dhe asnjëherë në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit shpenzimet e udhëtimit të mbuluara nga të afërm apo miq nuk janë konsideruar shpenzime të deklarueshme (apo dhurime), sepse nuk janë shpenzime të kryera nga subjekti.

33.15 Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

- Vërtetim të lëshuar nga shoqëria “G.T” sh.p.k. në datën 11.9.2023, në bazë të të cilit kjo shoqëri informon se subjekti dhe familjarë të saj kanë blerë biletat e avionit në periudhat e deklaruara sipas politikave të shitjeve të kompanive ajrore, që janë: (i) rezervime të hershme që ofrohen me çmime simbolike për efekt marketingu; (ii) rezervime në periudha të sezonit të ulët që janë me çmime ekonomike; (iii) shfrytëzimi i ofertave të ndryshme që bëjnë kompanitë në ditë dhe data të caktuara.
- Vërtetim datë 11.9.2023, ku shoqëria ka ritheksuar se *për paketat turistike në Antalia në gusht/verë 2009 – 2012 subjekti ka paguar vetëm pjesën e akomodimit në hotel me të gjitha përfshirë, ndërsa për biletat charter janë shfrytëzuar vendet bosh në ato data udhëtimi. Shoqëria ka theksuar se agjencitë turistike herë pas here kanë vende të mbetura bosh në charter, të cilat mund të ofrohen falas si pjesë e paketës turistike.*
- Vërtetim datë 11.9.2023, ku kjo shoqëri konfirmon se për paketat turistike në Antalia në gusht 2013 – 2016 subjekti ka paguar vetëm pjesën e udhëtimit, ndërsa për akomodimin në hotel me të gjitha përfshirë janë shfrytëzuar dhomat që merren falas nga agjencia, në bazë të kontratave me hotele të veçanta. Agjencia ka kontrata ekskluzive me disa hotele, që si pjesë e marrëveshjes përfshihen dhoma falas, që mund të shfrytëzohen nga agjencia me qëllim marketingu.

33.16 Subjekti kërkon që shpenzimet e udhëtimit të mbuluara nga përfaqësuesit e shoqërisë “G.T” nuk duhet të përfshihen në analizën financiare, sipas praktikës dhe standardit të Kolegjit, në zbatim edhe të parimit të barazisë përpara ligjit.

Vlerësimi i Komisionit lidhur me shpenzimet e udhëtimit

33.17 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga

Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

- Komisioni, pasi vlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në prapësime, çmon t'i konsiderojë pretendimet e subjektit, duke rishikuar analizën financiare lidhur me shpenzimet e udhëtimit.

33.18 Në konkluzion, për sa i përket udhëtimeve, trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka pasaktësi, pasi nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike dhe në deklaratën *Vetting* mbulimin e këtyre shpenzimeve, por u provua se ato nuk janë kryer për fshehje pasurie nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, ndaj dhe nuk duhet të ndikojnë në analizën e përgjithshme financiare të subjektit të rivlerësimit apo, në konkluzionin e përgjithshëm, mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

33.19 Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarin e pasaktë të të dhënave.

33.20 Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat e konstatuara nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe nuk kanë afektuar deklarin në deklaratën *Vetting* të vitit 2017.

34. Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2016

34.1 Nga analiza financiare e përgjithshme duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë balancë negative të shtrirë në vite në shumën totale 6.284.267 lekë.

Subjektit i kaloi barra e provës lidhur me këtë rezultat negativ.

Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në prapësime

34.2 Subjekti pretendon se Komisioni ka kryer analizë kumulative të prindërve në vite, duke përfshirë, përveç shpenzimeve të jetesës, të gjitha investimet e kryera nga prindërit, si dhe ato personale. Sipas subjektit, analiza financiare nuk është ndalur në justifikimin e pasurive dhe shumat monetare të dhuruara, por në analizimin e të gjitha pasurive të prindërve.

34.3 Subjekti pretendon se analiza dhe vlerësimi i pasurisë së prindërve duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhuruar apo dhënë hua dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar edhe jurisprudencës së deritanishme, si të Kolegjit, ashtu edhe të Komisionit (duke sjellë në vëmendje vendimin nr. 2, datë 2.2.2023, të Kolegjit).

34.4 Të gjitha efektet e kursit të këmbimit të depozitave në monedhën dollar duhet të korrektohen nga Komisioni për vlerat në fund të çdo viti për vitet 2013, 2014 dhe 2015 me të njëjten metodologji që është përdorur nga Komisioni në vitet e hershme, 2003 e në vazhdim.

34.5 Sipas subjektit, nga analiza progresive, duke përfshirë dy depozitat, por duke mos marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja e apartamentit në rrugën “K.K”, të ardhurat e punës së nënës në emigracion dhe të ardhurat e vëllait gjatë qëndrimit në Itali, rezulton se në vitin 2012 prindërit paraqiten me balancë negative në shumën -73.229 lekë dhe, në vitin 2014, me balancë negative në shumën -329.992 lekë.

34.6 **Për vitin 2005**, ku rezulton me pamundësi financiare në shumën -54.278 lekë, pretendon se Komisioni nuk i ka njohur 4 udhëtime të bashkëshortit të kryera gjatë vitit 2005, duke rënduar analizën financiare me +1.110 euro. Për këto katër udhëtime subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2020 “Sekret” dhe afat klasifikimi 20 vjet, ku konfirmohet se udhëtimet janë kryer për shërbim jashtë vendit dhe shpenzimet janë mbuluar 100 për qind nga buxheti i Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

34.7 Për këtë arsye, subjekti kërkon që Komisioni të ulë shpenzimet e udhëtimit në -1.110 euro. Analiza financiare pas korigjimit do të paraqitet me mundësi kursimi në shumën 125.359 lekë.

34.8 **Për vitin 2007**, ku sipas analizës së Komisionit rezulton me pamundësi financiare në shumën -1.656.132 lekë, subjekti ka prapësuar se në këtë vit kursimet nga paga në shumën 400.000 lekë nuk duhet të konsiderohen si kursime në gjendje *cash*, pasi janë pjesë e shumës së depozituar në llogarinë rrjedhëse dyemërore pranë Intesa Sanpaolo Bank. Gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2007 ka qenë në shumën 0 (zero) lekë.

34.9 Gjithashtu, në analizën financiare për vitin 2007 duhet të përfshihet shuma 6.000 euro e dhuruar nga nëna, si dhe të korigjohen shpenzimet e udhëtimit sipas sistemit TIMS, të cilat janë konsideruar nga Komisioni në shumën 265.397 lekë, ndërsa sipas deklarimeve në pyetësin standard vlera e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2007 është 137.233 lekë.

34.10 Subjekti ka prapësuar se për udhëtimin në Zvicër Komisioni ka përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit 210 euro, ndërsa vlera e shpenzuar prej saj është 50 euro, pasi shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit janë përballuar nga shtetasi V.Th.

34.11 Në vijim, subjekti ka prapësuar se vlera e paketës turistike në Antalia për vitin 2007 ka qenë në shumën 550 euro, ndërsa Komisioni ka përlllogaritur shpenzime udhëtimi në vlerën 1.450 euro. Subjekti ka shpjeguar se shoqëria “G.T” i ka ofruar paketa turistike në Antalia me çmim shumë të favorshëm dhe, deri në vitin 2012, shoqëria ka pasur në dispozicion paketa, të cilat kanë qenë me çmime të favorshme, ndërsa nuk ka paguar për biletat e *charter-it*, pasi nga shoqëria janë shfrytëzuar vendet bosh në ato data udhëtimi.

34.12 Për këtë arsye, me përfshirjen e të ardhurave nga dhurimi, mospërfshirja e kursimeve nga paga si kursime *cash*, pasi kursimet janë depozituar në bankë, dhe me korigjimin e shpenzimeve të udhëtimit, situata financiare nga -1.656.132 lekë do të paraqitet me mundësi kursimi në shumën +49.011 lekë.

34.13 **Për vitin 2012**, sipas analizës së Komisionit, subjekti rezulton me pamundësi financiare në shumën -1.195.293 lekë.

34.14 Subjekti pretendon se pagesa e kryer për blerjen e automjetit tip “Dacia Duster” në shumën 11.150 euro është kryer në fund të vitit 2011 dhe jo në datën 4.1.2012, pasi në këtë datë është

lëshuar fatura tatimore e shitjes. Gjithashtu, blerja e automjetit është deklaruar në DPV-në e vitit 2011 dhe jo në DPV-në e vitit 2012. Po ashtu, edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se në vitin 2011 është bërë rivlerësimi i mjetit dhe është shtuar vlera prej 11.150 euro. Po ashtu, në përgjigje të pyetësorit datë 18.11.2022, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit gjatë vitit 2011, si dhe dhurimi nga nëna në shumën 6.000 euro po gjatë këtij viti.

34.15 Gjithashtu në këtë vit, subjekti kërkon të përfshihet në analizën financiare edhe shuma e dhuruar nga nëna në vlerën 6.000 euro, e cila shërbeu si burim krijimi për blerjen e automjetit.

34.16 Për vitin 2012 duhet të korrighohen edhe shpenzimet e udhëtimit sipas deklarimeve të kryera në përgjigje të pyetësorit standard dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “G. T” në datën 11.9.2023, pasi, sipas analizës nga Komisioni, shpenzimet e udhëtimit nga 547.702 lekë duhet të korrighohen dhe të përfshihen në shumën 198.402 lekë.

34.17 Gjithashtu, shpenzimet e udhëtimit duhet të korrighohen edhe për vitin 2011 sipas deklarimeve dhe dokumentacionit justifikues ligjor të paraqitur.

34.18 **Për vitin 2013**, subjekti kërkon të korrighohen shpenzimet e udhëtimit, të cilat nuk janë konsideruar sipas shpenzimeve të deklaruara në pyetësorin standard dhe dokumentacionin justifikues ligjor të paraqitur, si dhe gjendja e kursimeve *cash*. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2013 janë njohur nga Komisioni në shumën 722.783 lekë, ndërkohë shpenzimet e kryera nga familja e subjektit janë në shumën 279.719 lekë. Me korrighimin e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2013, situata financiare nga pamundësi në shumën -233.420 lekë do të rezultojë me mundësi kursimi në shumën 609.644 lekë.

34.19 **Për vitin 2014**, ku subjekti rezulton me pamundësi financiare në shumën -880.496 lekë, kërkon që Komisioni të korrighojë shpenzimet e udhëtimit për këtë vit sipas deklarimeve dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion Komisionit dhe, për rrjedhojë, situata financiare e subjektit do të paraqitet me mundësi kursimi në shumën 126.523 lekë.

34.20 **Për vitin 2015**, subjekti ka prapësuar se vlera 14.500 euro nuk duhet të konsiderohet si gjendje *cash*, pasi në llogarinë e BKT-së e ka tërhequr këtë shumë duke ia dhënë nënës. Pra, sipas subjektit, në analizën financiare vlera 14.500 euro nuk do të konsiderohet si shtesë e kursimeve *cash* (sepse edhe sipas jurisprudencës së konsoliduar subjekti nuk ka deklaruar shtim të gjendjes *cash*, por vetëm përshkrim të veprimit bankar të kryer prej saj gjatë vitit), pasi kjo shumë nuk është deklaruar si kursim *cash* në DPV-në e vitit 2015.

34.21 Gjithashtu, subjekti kërkon korrighimin e shpenzimeve të udhëtimit sipas deklarimeve në pyetësorin standard, shoqëruar me dokumentacionin e administruar nga shoqëria dhe, për rrjedhojë, situata financiare do të paraqitet me balancë pozitive në shumën 493.036 lekë.

34.22 Subjekti ka referuar disa vendime të Kolegjit¹³, ku sipas jurisprudencës së konsoliduar balancat negative në vlera jo materiale, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore.

Vlerësimi i Komisionit mbi analizën e subjektit pas prapësimeve

34.23 Komisioni, në vlerësim të çështjeve të trajtuara sa më sipër, të reflektuara në analizë, paraqitet situatën financiare të subjektit të rivlerësimit pas prapësimeve në tabelën vijuese.

Analiza financiare e subjektit pas prapësimeve

Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri neto	Të ardhura	Shpenzime	Rezultati financiar
2003	436 158	-	436 158	998 681	281 892	280 631
2004	249 107	-	249 107	1 125 726	402 295	474 324
2005	2 442 185	980 320	1 461 865	2 026 181	438 957	125 359
2006	161 217	-	161 217	2 148 830	458 595	1 529 018
2007	1 783 970	-	1 783 970	2 543 510	1 162 047	- 402 507
2008	1 587 606	-	1 587 606	3 709 012	1 183 190	938 215
2009	539 644	-	539 644	2 946 691	1 128 627	1 278 420
2010	81 597	-	81 597	3 456 042	1 081 320	2 293 126
2011	482 191	-	482 191	2 897 253	831 135	1 583 927
2012	1 087 319	-	1 087 319	2 159 844	1 251 985	- 179 460
2013	354 138	-	354 138	1 973 446	1 009 665	609 644
2014	1 201 248	-	1 201 248	2 756 858	1 429 087	126 523
2015	1 277 174	-	1 277 174	2 849 515	1 430 041	142 300
2016	84 322	-	84 322	2 836 794	1 963 388	789 084

34.24 Nga sa më sipër, analiza përfundimtare për gjithë periudhën rezultoi me një balancë negative në shumën 402.507 lekë në vitin 2007, dhe 179.460 lekë në vitin 2012.

34.25 Nga analizimi i të ardhurave të dokumentuara ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka disponuar burime të ligjshme për krijimin e pasurisë, mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e likuiditeteve për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Diferenca negative nuk është në masën që të passjellë marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion i Komisionit mbi kriterin e pasurisë

34.26 Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mundur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj.

34.27 Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në

¹³ Vendimet nr. 38, datë 6.12.2021; nr. 17/2022 (subjekti M. O (N); nr. 2 (JR), datë 2.2.2023; nr. 4 (JR), datë 16.2.2023; nr. 19 (JR), datë 10.6.2022.

tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit është në përputhje me detyrimet ligjore që ajo ka pasur në zbatim të legjislacionit.

34.28 Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, fakteve dhe rrethanave të konstatuara në vlerësimin e komponentit të pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, si dhe nuk ka kryer deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

- 35.** AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

35.1 Në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar në datën 2.11.2017 raportin mbi kontrollin e figurës, me konstatimin mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi.

Hetimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

35.2 Komisioni në janar të vitit 2023 ka kërkuar përditësim të të dhënave për subjektin e rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, nga ku nuk rezultuan të dhëna shtesë.

35.3 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

35.4 Komisioni ka kërkuar përditësim të dhënash pranë AKSIK-së dhe, në përgjigje, është informuar se nuk disponohen informacione shtesë.

Vlerësimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

35.5 Nga hetimi i Komisionit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Formulari i deklarimit për figurën është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

35.6 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

36. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

36.1 Raporti i KLP-së është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme; (iv) të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në KLP.

GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT

37. Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar saktë, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

a) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, ka deklaruar se për periudhën tetor 2013 – tetor 2016 e në vazhdim ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa i përket të dhënave statistikore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një shifër të përgjithshme të çështjeve të caktuara, të përfunduara dhe të mbartura, ku në tri vitet e fundit të detyrës i janë caktuar 296 procedime penale, si dhe 173 materiale kallëzuese; ka përfunduar 269 procedime penale dhe çështje të mbartura në vitin e fundit të ushtrimit të detyrës janë 27 procedime penale.

b) Trajnimet në 3 vitet e fundit

Sa i përket trajnimeve të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës, brenda periudhës së rivlerësimit subjekti rezulton të ketë kryer disa prej tyre, kryesisht gjatë viteve 2014 dhe 2015. Subjekti ka dorëzuar disa dokumente, sipas të cilave ka qenë pjesëmarrëse në disa trajnime të organizuara brenda dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

c) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti Suela Salavaçi ka paraqitur 3 dokumente ligjore brenda periudhës së rivlerësimit, si vijon:

- kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015”;
- vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015;
- kërkesë për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit.

- ✓ Nga verifikimi i akteve sa më sipër, Komisioni nuk ka evidentuar problematika.

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

38. Subjekti i rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, nga data 8.10.2013 dhe deri në datën 8.10.2016 ka ushtruar detyrën e saj funksionale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- ✓ Nga analizimi i 5 dosjeve të shortuara, Komisioni nuk ka evidentuar problematika.

39. Vlerësimi sipas katër grup-kritereve, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka rezultuar si vijon:

Lidhur me aftësitë profesionale

39.1 Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara evidentohet se prokurorja Suela Salavaçi shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit dhe arsytimit ligjor, duke identifikuar saktë normën ligjore të zbatueshme. Në aktet e përgatitura nga subjekti konstatohet kryerja e një analize mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore.

Lidhur me aftësitë organizative

39.2 Evidentohet efektiviteti në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve, duke përballuar ngarkesën e punës.

Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

39.3 Nga dosjet e vëzhguara ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale.

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

39.4 Evidentohet pjesëmarrja e saj në një sërë trajnimesh të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga organizma ndërkombëtarë.

TË DHËNAT ARKIVORE

40. Nga verifikimi i të dhënave arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se për prokuroren Suela Salavaçi nuk ka pasur masa disiplinore apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

41. Sipas regjistrit të ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2020 kanë rezultuar 16 ankesa ndaj prokurores Suela Salavaçi, për të cilat iu kërkuan shpjegime, si vijon:

41.1 Ankesa nr. *, viti 2019, e shtetasit F.Sh.**, i cili ka kryer kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vjedhjen e pasurisë (kioskë), çështje e cila është hetuar nga prokurorja Suela Salavaçi. Ankuesi në datën 30.3.2017 ka paraqitur kallëzim penal ndaj Bashkisë Tiranë për prishjen e pronës së tij private. Ankuesi pretendon se nuk ka marrë asnjë informacion nga Prokuroria në lidhje me ecurinë e hetimeve, si dhe pretendon për shkelje të etikës së komunikimit nga prokurorja e çështjes dhe oficeri i policisë gjyqësore.

41.2 Me verifikimet e realizuara nga Prokuroria e Përgjithshme ka rezultuar se hetimet e procedimit penal sa më sipër ishin pezulluar në vitin 2017 e, në këto kushte, është kërkuar fashikulli i procedimit me qëllim kontrollin e veprimtarisë së prokurorit.

41.3 Referuar shkresës nr. *** prot., datë 28.1.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme, evidentohet se kallëzimi i paraqitur nga shtetasi F.Sh është regjistruar me nr. kallëzimi ***, datë 4.4.2017 dhe, më pas, është regjistruar si procedim penal nr. ***, datë 13.7.2017, për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal. Një ditë pas regjistrimit të procedimit, në datën 14.7.2017, është vendosur pezullimi i procedimit penal dhe fashikulli i është dërguar policisë. Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar kopje të fashikullit për efekt të studimit të dosjes për ta verifikuar.

41.4 Subjektit iu kërkuar shpjegime në lidhje me sa pretendohet nga ankuesi, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

41.5 Subjekti përmes prapësimeve të saj ka shpjeguar veprimet hetimore të kryera për çështjen në fjalë, ku në datën 4.4.2017 është regjistruar kallëzimi i shtetasit F.Sh dhe, në datën 5.4.2017, nëpërmjet procedurës së shortit manual i është caktuar për ndjekje nga drejtuesi i seksionit. Materiali është marrë në dorëzim në datën 11.4.2017.

41.6 Subjekti ka shpjeguar se me qëllim identifikimin e veprës penale janë kryer një sërë veprimesh hetimore, si marrja e deklarimeve kallëzuesit ku, ndër të tjera, ai shpjegon se *nuk e ka pasur asnjëherë në përdorim kioskën, megjithëse është pronar, pasi e përdorte një person tjetër që ai nuk ia di identitetin*. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ka kërkuar informacion pranë Bashkisë Tiranë në lidhje me problematikat që ngre kallëzuesi dhe ka rezultuar se nga Bashkia Tiranë dhe Policia Bashkiake nuk janë kryer procedura ligjore dhe nuk kanë dijeni për akte administrative ndaj subjektit.

41.7 Pas kryerjes së këtyre veprimeve verifikuese, në datën 13.7.2017 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal dhe më pas është vendosur pezullimi i tij. Subjekti ka argumentuar se vendimi i pezullimit nuk është vendim përfundimtar që zgjidh çështjen, por dërgohet për hetime të mëtejshme me qëllim zbulimin e autorit. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka paraqitur kopje të dosjes penale nr. ***.

Vlerësimi i Komisionit

41.8 Trupi gjykues, pasi vlerësoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, si dhe shpjegimet e parashtruara prej saj, evidenton se çështja penale në fjalë nuk ka marrë zgjidhje, pasi nuk rezultoi që nga ana e Bashkisë Tiranë të ishin kryer procedura ligjore për zhvendosjen e kioskës.

41.9 Nga verifikimi i fashikullit të çështjes penale evidentohet se nga data e regjistrimit të materialit kallëzues në prill 2017 deri në momentin e regjistrimit të procedimit penal korrik 2017 janë kryer një sërë veprimesh verifikuese, si dhe është administruar dokumentacioni në funksion të këtij kallëzimi.

41.10 Lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk ka marrë asnjë informacion nga organi i Prokurorisë për ecurinë e çështjes, Komisioni, duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale “Pezullimi i hetimeve” (para ndryshimeve të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën 1.8.2017), evidenton se subjekti nuk ka pasur detyrimin ligjor për të njoftuar ankuesin lidhur me vendimin e pezullimit të çështjes.

✓ Shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

DENONCIMET

42. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, janë depozituar në total 18 denoncime. Pas analizimit nga Komisioni, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumentacion mbështetës për 4 prej tyre, si vijon:

43. Denoncim i shtetasit S. S

43.1 Ky shtetas ankohet se ka paraqitur 5 kërkesa për marrjen e një kopjeje të akteve të dosjes hetimore nr. ***, viti 2017, por prokurorja Salavaçi nuk i ka dhënë mundësi për t’u njohur me këto akte, megjithëse përbën detyrim ligjor referuar neneve 105 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale.

43.2 Denoncuesi pretendon se ka marrë nëpërmjet shërbimit postar vetëm vendimin e datës 12.7.2018 dhe kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj tij, si i akuzuar për veprën penale “Mashtrimi në kredi”, parashikuar nga Kodi Penal dhe nuk është njohur me aktet në momentin e përfundimit të hetimeve datë 25.6.2018.

43.3 Lidhur me sa pretendon denoncuesi, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumentacion mbështetës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

43.4 Subjekti përmes prapësimeve të saj ka shpjeguar se në datën 3.7.2018 i pandehuri S. S është njohur me përfundimin e hetimeve, si dhe me aktet e procedimit penal, i papërfaqësuar nga ndonjë mbrojtës me prokurë apo i zgjedhur prej tij. Në këtë akt, ai ka bërë shënimin që brenda afatit ligjor 10-ditor do të paraqesë memo, si dhe kërkon që të marrë kopje të akteve të procedimit penal. Dosja është dërguar për gjykim në përfundim të afatit 10-ditor.

43.5 Në datën 15.7.2018, si prokurore e çështjes, mbi bazën e kërkesave të të pandehurit S. S dhe av. K.I(pa prokurë), subjekti i është drejtuar me shkresë OPGJ-së G.F, si dhe zyrës së sekretarisë dhe zyrës së financës për dhënien e akteve të pandehurit.

43.6 Sipas subjektit, ecuria e mëtejshme e kësaj pjese nuk është përgjegjësi e prokurorit, por e oficerit të policisë gjyqësore dhe administratës, megjithëse denoncuesi këto akte i ka marrë në datën 22.10.2018 (pasi i është dashur 1 javë për t’u vulosur aktet në kryesekretari).

43.7 Me vendimin nr. ***, datë 11.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehurit S.S, vendim i cili është ankimuar nga ana e prokurorit dhe, siç rezulton nga shkresa nr. *** prot., datë 6.9.2023, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është caktuar relatori i çështjes, por ende nuk është planifikuar për gjykim.

43.8 Shtetasi S.S ka bërë ankesa edhe pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por me vendimin nr. *** prot., datë 11.6.2021, pas verifikimit është vendosur arkivimi i tyre.

43.9 Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka vënë në dispozicion edhe dokumentacionin mbështetës:

- vendimin nr. *** prot., datë 11.6.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- shkresën e datës 15.7.2018, drejtuar OPGJ-së G.F, zyrës së sekretarisë dhe zyrës së financës;
- shkresën nr. *** prot., datë 6.9.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- njoftimin për përfundimin e hetimeve datë 25.6.2018 për të pandehurin S.S.

Vlerësimi i Komisionit

43.10 Komisioni vlerëson se subjekti përmes shpjegimeve të saj dhe akteve të depozituara në prapësime arriti të provojë të kundërtën e pretendimeve të ngritura nga ankuesi, ku përmes shkresës datë 15.7.2018 ka ngarkuar oficerin e policisë gjyqësore për dhënien e një kopjeje të akteve të këtij procedimi penal.

43.11 Gjithashtu, lidhur me pretendimin e denoncuesit se është njohur vetëm me vendimin dhe kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj tij në datën 12.7.2018, subjekti arriti të provojë të kundërtën, pasi tek akti “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, datë 25.6.2018, denoncuesi ka nënshkruar vetë me shkrim dore marrjen e njoftimit dhe paraqitjen e memove brenda një afati ligjor 10-ditor.

43.12 Nga verifikimi i kryer lidhur me këtë çështje nuk u evidentua ndonjë shkelje ligjore nga subjekti i rivlerësimit apo ndonjë veprim që cenon aftësitë e saj profesionale.

44. Denoncim i shtetasit I. Ç

44.1 Ky shtetas ankohet për hetim të njëanshëm dhe jo të plotë të çështjes lidhur me shitjen e një prone (hotel) nga denoncuesi tek shtetasi U. P. në vitin 2017, për të cilën blerësi ka depozituar në llogarinë e noteres 1.2 milionë euro, por kjo e fundit nuk i ka kaluar shumën shitësit, pasi përmes mashtrimit blerësi refuzoi nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitjes. Sipas denoncuesit, prokurorja pa u hedhur shorti sipas rregullit, ka marrë për ndjekje çështjen e tij me qëllim favorizimin e personave të kallëzuar prej tij.

44.2 Çështja penale është pushuar nga subjekti si prokurore e çështjes, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit dhe e Apelit. Pas rekursit të ushtruar nga ankuesi, ky vendim është prishur nga Gjykata e Lartë në datën 29.9.2022, me argumentin se nuk janë shqyrtuar shkaqet e ankimit, si dhe kërkesë-memot e bëra nga denoncuesi, duke cenuar paanshmërinë e hetimit të çështjes dhe në vijim të procesit gjyqësor.

44.3 Gjithashtu, denoncuesi ankohet se kopja e vendimit të pushimit i është dërguar në adresën e hotelit të shitur prej tij dhe jo në adresën e deklaruar para oficerit të policisë gjyqësore.

44.4 Në lidhje me pretendimet e denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumentacion mbështetës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

44.5 Lidhur me pretendimin e denoncuesit se subjekti ka ndërhyrë për të marrë çështjen pa u hedhur shorti sipas rregullit, subjekti përmes prapësimeve të datës 20.9.2023 ka shpjeguar se ky material kallëzues i është caktuar nëpërmjet procedurës së shortit manual të hedhur nga drejtuesi i seksionit. Subjekti ka paraqitur si dokument provues formularin për trajtimin e materialit kallëzues nr. ***, datë 18.7.2019, të nënshkruar nga drejtuesi i seksionit, z. G.Q, të administruar në dosje.

44.6 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në datën 24.10.2019 është depozituar një kallëzim penal nga shtetasi U.P ndaj shtetasit I.Ç. Ky material me të njëjtin objekt i është caktuar pa short nga drejtuesi i Prokurorisë, pasi kishte në hetim materialin e parë kallëzues në mbështetje të nenit 93 të Kodit të Procedurës Penale.

44.7 Subjekti ka prapësuar se pretendimet e denoncuesit për njohje apo marrëdhënie miqësore me subjektet në hetim nuk janë të vërteta, nuk ka pasur ndonjëherë komunikime me noteren në rrjetet sociale, pasi nuk është aktive në to.

44.8 Subjekti ka shpjeguar se pas kërkesës së kallëzuesit I.Ç, edhe pse nuk ishte para kritereve ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, ka deklaruar heqjen dorë nga vazhdimi i hetimeve të procedimit penal me kërkesën datë 28.1.2020, kërkesë e cila nuk është pranuar nga drejtuesi i Prokurorisë, vendim i cili i është komunikuar edhe këtij shtetasi me shkresën nr. ***prot., datë 30.1.2020.

44.9 Subjekti ka prapësuar se nga ana e saj janë kryer të gjitha veprimet e duhura dhe të nevojshme hetimore në mënyrë të paanshme dhe objektive dhe, më pas, i është bërë kërkesë Gjykatës për pushimin e hetimeve, kërkesë e cila është miratuar si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, edhe nga Gjykata e Apelit. Aktualisht kjo çështje është në gjykim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pasi është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë (sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 8.9.2023).

44.10 Sa i përket pretendimit të denoncuesit se vendimi i pushimit nuk i është dërguar në adresën e referuar prej tij para oficerit të policisë gjyqësore, subjekti ka prapësuar se kopja e kërkesës për pushim i është dërguar kallëzuesit në adresën që ai vetë ka dhënë gjatë kallëzimit të bërë, e shënuar në procesverbalin përkatës të datës 13.3.2017. Nga studimi i fashikull penal, subjekti konstaton se nga ana e kallëzuesit janë dhënë disa adresa të ndryshme në lidhje me vendbanimin e tij.

44.11 Sipas subjektit, megjithëse shkresat e ndodhura në dosje nuk janë firmosur nga drejtuesi i Prokurorisë, nisja e tyre vërtetohet nga libri i dorëzimit të vitit 2020 dhe mbajnë datën 28.5.2020.

44.12 Shtetasi I.Ç ka bërë ankesa edhe pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të njëjtat çështje që ka bërë në ankesën pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe me vendimin nr. *** prot., datë 10.2.2023, është vendosur arkivimi i tyre pas verifikimit të ankesës.

44.13 Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar dokumentacion provues:

- formular për trajtimin e materialit kallëzues nr. ***, datë 18.7.2019;
- kallëzim penal i shtetasit U.P, datë 24.10.2019;
- kërkesë për deklarimin e heqjes dorë për procedimin penal nr. ***/2019;

- shkresë përcjellëse nr. *** prot., datë 30.1.2020, së bashku me vendimin datë 29.1.2020, nga drejtuesi i Prokurorisë;
- vërtetim nr. *** prot., datë 8.9.2023, i Gjykatës së Apelit Tiranë;
- procesverbal datë 13.3.2017, i kallëzimit të shtetasit I.Ç;
- shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2023, e ILD-së;
- libër dorëzimi i brendshëm, viti 2020;
- vendimi nr. regj. them. ***, datë 9.7.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 19.10.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vlerësimi i Komisionit

44.14 Komisioni, pas analizimit të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, çmon se subjekti arriti të provojë të kundërtën e pretendimeve të ngritura nga ankuesi, për sa i përket ndjekjes së çështjes penale sipas procedurave të hedhjes së shortit, si dhe komunikimit të vendimit të pushimit në adresën e referuar prej denoncuesit. Komisioni nuk ka evidentuar ndonjë shkelje ligjore apo mangësi profesionale.

45. Denoncim i shtetas F.Y¹⁴

45.1 Kjo shtetase ankohet për prokuroren Salavaçi lidhur me një kallëzim të kryer prej saj ndaj shtetasve A. P. dhe P. L. për veprat penale “Dhunimi i banesës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga Kodi Penal. Sipas ankueses, çështja penale është mbajtur e paregjistruar 1 vit e 2 muaj dhe më pas është vendosur mosfillimi i hetimeve. Kallëzuesja ka qenë pronare e ligjshme e një banese 2-katëshe në Tiranë të blerë në vitin 1996 dhe, në vitin 2006, prona e saj i është shitur shtetasit D. B. përmes një prokure të falsifikuar në emrin e saj si shitëse, e përdorur nga bashkëshorti i saj.

45.2 Në vitin 2012, kjo pronë i shitet shtetasit P. L., i cili përmes zyrës përmbarimore e ka nxjerrë kallëzuesen nga banesa, megjithëse kishte dijeni se kontrata e shitjes ishte konstatuar absolutisht e pavlefshme me vendim gjyqësor të datës 4.5.2015.

45.3 Çështja penale është regjistruar në datën 2.7.2019 dhe, në përfundim të veprimeve hetimore, në datën 25.11.2019, prokurorja Suela Salavaçi ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes, me argumentin se faktet e hetuara nuk parashikohen nga ligji si vepër penale.

45.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 20.1.2020, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal dhe vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, duke konstatuar se nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm.

45.5 Subjektit iu kërkuar shpjegime dhe dokumentacion mbështetës në lidhje me pretendimet e denoncuesit për mosregjistrim të procedimit dhe kthimin e akteve nga gjykata për hetim të paplotë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

45.6 Lidhur me pretendimet e denoncueses për mosregjistrim të çështjes penale për 1 vit e 2 muaj, subjekti i rivlerësimit përmes prapësimeve të saj ka shpjeguar se ky kallëzim penal është

¹⁴ Denoncim nr. ** prot., datë 28.4.2021.

paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Tiranë me nr. *** prot., datë 21.6.2019, i cili është regjistruar në datën 28.6.2019, me nr. kallëzimi *** dhe i është caktuar subjektit nëpërmjet procedurës së shortit manual nga drejtuesi i seksionit në datën 28.6.2019. Në vijim, në datën 2.7.2019 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal, i cili mban numrin ***, pra është regjistruar vetëm 4 ditë pas regjistrimit dhe shortimit të tij. Subjekti sqaron se nuk është vendosur asnjëherë mosfillimi i hetimeve në lidhje me këtë material kallëzues.

45.7 Sipas shpjegimeve të subjektit, pasi janë kryer veprimet hetimore të nevojshme në datën 25.11.2019, është hartuar kërkesa për pushimin e procedimit penal dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. regj. them. S. P. ***, datë 20.1.2020, ka vendosur rikthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme. Ndaj këtij vendimi prokurori ka ushtruar apel me shkresën nr. ** prot., datë 5.2.2020 dhe kjo çështje për të cilën është caktuar relatori, nuk është planifikuar për gjykim (sipas shkresës nr. *** prot., datë 6.9.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm). Subjekti deklaron në përgjegjësinë morale dhe ligjore se nuk ka njohje me asnjë nga subjektet e këtij procedimi penal.

45.8 Në mbështetje të shpjegimeve të saj subjekti ka depozituar:

- formularin për trajtimin e materialit kallëzues nr. ***, datë 28.6.2019;
- urdhrin e regjistrimit të procedimit penal datë 2.7.2019;
- kallëzimin e shtetas F. Y., datë 21.6.2019;
- shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 5.2.2020, së bashku me ankimin;
- shkresën nr. *** prot., datë 6.9.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Vlerësimi i Komisionit

45.9 Trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka dhënë shpjegime mbi arsyet e kthimit të akteve nga Gjykata dhe vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, por informon lidhur me faktin se kjo çështje është ende në shqyrtim nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

45.10 Komisioni çmon faktin se çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sa i përket regjistrimit të materialit kallëzues, Komisioni konstaton se subjekti arriti të provojë përmes akteve se regjistrimi i procedimit penal është kryer brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

46. Denoncim i shtetasve Sh. H, L. B (H) dhe L. B (H)

46.1 Denoncuesit kanë parashtruar të dhëna lidhur me kallëzimin e tyre të regjistruar nr. ***/2014 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, pas veprimeve hetimore, me vendimin e datës 20.10.2015 ka vendosur pushimin e hetimeve.

46.2 Këta shtetas ankohen ndaj prokurores Salavaçi lidhur me një kallëzim penal të kryer prej tyre në vitin 2014 ndaj punonjësve të administratës vendore dhe qendrore, duke i akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Në përfundim të hetimeve, në datën 20.10.2015, subjekti ka vendosur pushimin e hetimeve, që është shfuqizuar tri herë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

46.3 Denoncuesit ankohen se nuk janë njoftuar dhe as janë thirrur në cilësinë e kallëzuesve për ndonjë vendimmarrje të mundshme nga ana e Prokurorisë dhe për kërkesën e tretë të saj të paraqitur në Gjykatë në maj të vitit 2019, nuk janë njoftuar nga organi i akuzës, por janë vënë në dijeni rastësisht. Gjithashtu, denoncuesit ankohen se nuk është respektuar afati i hetimeve të përcaktuara nga gjykata me vendimin gjyqësor, si dhe nuk kanë asnjë njoftim shkresor nga Prokuroria.

46.4 Komisioni ka administruar fashikullin e dosjes penale, ku nga verifikimi i kryer duket se:

- Kërkesa për pushimin e çështjes në dhjetor 2019 dhe kërkesa për pushim e datës 20.11.2018 nuk u është komunikuar kallëzuesve. Shkresat përcjellëse nuk përmbajnë as datë dhe as numër protokoli.
- Nuk janë përfunduar hetimet brenda afatit 90-ditor të përcaktuar në vendimin gjyqësor të datës 10.5.2019 (i cili ka marrë formë të prerë në datën 28.6.2019).
- Nuk janë kryer hetime të plota sipas detyrave të caktuara nga gjykata, edhe pse në mënyrë të përsëritur.

46.5 Në lidhje me këto konstatime subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

46.6 Lidhur me pretendimet e denoncuesve se kallëzuesve nuk u janë komunikuar kërkesat për pushimin e çështjes në dhjetor 2019 dhe nëntor 2018, subjekti ka shpjeguar se prokurorët pas përfundimit të një procedimi penal e dërgojnë dosjen tek drejtuesi i seksionit, i cili pas siglimit ia çon drejtuesit të Prokurorisë për nënshkrimet përkatëse dhe ky i fundit e dërgon në sekretari, ku kryhen veprimet administrative, si dërgimi i njoftimeve, fashikujve apo arkivimi i tyre.

46.7 Subjekti sqaron se prokurori i çështjes nuk ka më kontakt me dosjen pas dërgimit tek drejtuesi i seksionit dhe nënshkrimi apo nisja e njoftimeve nuk është përgjegjësi e prokurorit.

46.8 Në rastin konkret, subjekti ka administruar kopje të faqeve të librit të dorëzimit, në të cilat regjistrohen të gjitha shkresat që u nisen personave (kallëzues ose të kallëzuar), si dhe institucioneve të ndryshme, nga i cili rezulton se në datën 26.11.2018 është nisur shkresa për shtetasin Sh. H dhe, në datën 26.12.2019 është nisur shkresa e dytë për vendimmarrjen tjetër për shtetasin Sh. H.

46.9 Lidhur me konstatimin e Komisionit se hetimet nuk janë përfunduar brenda afatit 90-ditor të përcaktuar në vendimin gjyqësor të datës 10.5.2019 (i cili ka marrë formë të prerë në datën 28.6.2019), subjekti e konsideron të drejtë si konstatim, për të cilin ka shpjeguar se muaji gusht është periudha e lejeve vjetore. Gjithashtu janë kryer një sërë veprimesh hetimore që kanë kërkuar kohë, si verifikimet në lidhje me shtetasin Sh.Ç me qëllim thirrjen dhe marrjen e deklarimeve, ku kërkimet për të kanë përfunduar në datën 27.11.2019, si dhe kthimet e përgjigjeve nga institucionet, ku përgjigjja e fundit nga ASHK-ja ka ardhur në datën 23.10.2019 dhe, pas studimit të tyre, rezultoi se kishte mungesa dhe, më pas, janë këqyrur dhe marrë nga oficeri i policisë gjyqësore. Në datën 3.12.2019 është përpiluar relacioni përfundimtar nga oficeri

i policisë gjyqësore dhe në datën 4.12.2019 është kryer kërkesa për pushimin e procedimit penal nga ana e prokurorit.

46.10 Sa i përket konstatimit të Komisionit se nga ana e subjektit nuk janë kryer hetime të plota sipas detyrave të caktuara nga gjykata, e cila ka kthyer aktet 4 herë për hetime të mëtejshme, subjekti ka dhënë shpjegime për secilin nga vendimet e gjykatës dhe specifikisht detyrat e lëna prej saj, të cilat janë zbatuar nga subjekti.

46.11 Subjekti ka shpjeguar se në përfundim të çështjes, në datën 21.4.2021, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 4.5.2020, pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e procedimit penal. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka paraqitur:

- libër dorëzimi, viti 2018;
- libër dorëzimi, viti 2019;
- vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. * regj. them., datë 4.5.2020.

46.12 Në vijim, subjekti sqaron se ka kërkuar pranë ILD-së nëse denoncuesit F.Y, F.Sh dhe Sh.H etj. kanë paraqitur ankesa dhe nëse ka vendimmarrje nga ky institucion.

46.13 Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2023, të ILD-së, ku sqarohet se kanë bërë ankim shtetasit Sh.H, L.B(H) dhe L.B (H) dhe nuk ka ankesa nga shtetasit F.Y dhe F. Sh, ndërsa ankesa e bërë nga familja H, bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është në proces verifikimi.

Vlerësimi i Komisionit

46.14 Në prapësime, subjekti shpjegoi veprimet e kryera prej saj, në zbatim të vendimeve gjyqësore, si dhe arsyen e vonësës së veprimeve hetimore tej afatit të caktuar nga gjykata. Ajo dha shpjegime mbi arsyet që kanë çuar në kthimin e çështjes nga gjykata për hetime të mëtejshme.

46.15 Nisur nga fakti se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 21.4.2021 ka pranuar vendimin e subjektit për pushimin e çështjes, mbetet i paqartë kthimi i akteve nga gjykata në mënyrë të përsëritur.

46.16 Komisioni çmon të referojë pranë organit kompetent ILD për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me kallëzimin e regjistruar nr. ***, viti 2014, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

47. Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

47.1 Lidhur me këtë kriter, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar *e aftë* profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të referojë pranë organit kompetent ILD për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me kallëzimin e regjistruar nr. ***, viti 2014, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, më 28.9.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare/ Kundër

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha